

iNFOSTAT



REVISTË INFORMATIVE

NR. 03

INFOSTAT 03

Drejtor botimi: **Dr. Elsa Dhuli**

Bordi Editorial

1. Helda Curma, Instituti i Statistikave
2. Altin Xhikneli, Instituti i Statistikave
3. Majlinda Nesturi, Instituti i Statistikave
4. Erjola Gjika, Instituti i Statistikave
5. Ilirjana Kraja, Instituti i Statistikave

Koordinator: Enkelejt Avdyli, Instituti i Statistikave

© Copyright INSTAT 2023

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij
në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të
mbajtësit të së drejtës së autorit.

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: + 355 4 2222411 / 2233356
Fax: +355 4 2222 411
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

Design: Gentian Suçi

P Ë R M B A J T J A

Faqe
5

**Oferta turistike në Shqipëri
Vitet 2018-2021**

**Ndikimi i pandemisë në
sjelljen e biznesit në vite**

Faqe
17

Faqe
27

**Si ndikojnë masat administrative
të marra nga autoritetet rrugore
në numrin e aksidenteve**

**Keqpërdorimi dhe keqinterpretimi
i statistikave zyrtare**

Faqe
39

Faqe
45

**Trajtimi i mos përgjigjes në
anketën e të ardhurave dhe
nivelit të jetesës në Shqipëri**

OFERTA TURISTIKE NË SHQIPËRI VITET 2018-2021

ERVISA BUSHATI¹
RUDI BREGU²

Abstrakt

Sektori i Turizmit luan një rol të rëndësishëm për sa i përket potencialit të tij ekonomik dhe punësimit në vend. Prodhimi i statistikave të një cilësie të lartë, koherente dhe të harmonizuara mbi turizmin, konsiderohet sot si një ndër kërkesat më të rëndësishme për t'iu ardhur në ndihmë studiuesve, politikëbërësve si dhe për t'i dhënë një shtysë zhvillimit të këtij sektori. Për të plotësuar kërkesat në rritje për Statistikat e Turizmit, INSTAT ka nisur prodhimin e statistikave të akomodimit nga ana e ofertës bazuar në Rregulloren së Bashkimit Europian (EU) Nr. 692/2011. Rezultatet e këtij studimi bazohen në Anketën e Strukturave Akomoduese për vitet 2018-2021, do të shqyrtohen proceset nëpër të cilin kalon prodhimi i treguesve, dizenjimi i kampionit të anketës, mbledhja e të dhënave, përpunimi dhe paraqitje e gjetjeve nga vlerësimet në këtë periudhë kohore. Pjesë e analizës do të jetë dhe shtesa e ofertës së akomodimit turistik bazuar në treguesit e lejeve të ndërtimit të miratuara për hotele dhe struktura të ngjashme si dhe statistika për punësimin në këtë sektor.

Fjalë kyçe:

Turizmi; Strukturat akomoduese; Dhoma; Shtretër; Norma e shfrytëzimit.

1. Instituti i Statistikave, ebushati@instat.gov.al

2. Instituti i Statistikave, rbregu@instat.gov.al

1. HYRJJE

Turizmi po hyn në kryefjalën e zhvillimit ekonomik, social dhe kombëtar të vendit tonë. Të dhënat vit pas viti dëshmojnë peshën e turizmit si një ndër sektorët që sjellin më shumë të ardhura në buxhetin e shtetit, buxhetin sipërmarrës dhe atë familjar, me një kontribut direkt në PBB prej 8,5 % dhe një vlerë të shtuar indirekte prej 26,2 % (Strategjia e zhvillimit të turizmit, 2019-2023).

Rregullorja Evropiane (KE) Nr. 692/2011 krijon një kornizë me anë të së cilës grumbullohen dhe prodhohen statistikave të turizmit, në mënyrë të harmonizuar në nivel evropian. Statistikat e turizmit mbulojnë turizmin si nga ana e ofertës (akomodimi) ashtu edhe nga ana e kërkesës (udhëtime të brendshme dhe të jashtme).

Nisur nga viti 2016, INSTAT ka filluar të prodhojë të dhëna mujore për turizmin, nëpërmjet publikimit të titulluar “Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri”. Informacioni i mbledhur dhe i publikuar është shumë i rëndësishëm për përdoruesit kombëtarë të statistikave për prodhimin e të cilit është zbatuar metodologjia e Organizatës Botërore të Turizmit (UNWTO, 2019). Duke pasur parasysh këtë, duheshin zhvilluar metoda alternative të mbledhjes së të dhënave në mënyrë që të sigurohej që sistemet e INSTAT të jenë në përputhje me standardet evropiane.

Në vitin 2017, INSTAT me mbështetjen e IPA-2014 filloi grumbullimin e të dhënave me mbulim të plotë mbi statistikave të turizmit nga ana e ofertës (Shtojca I e Rregullores). Mbledhja e të dhënave kryhet nëpërmjet vrojtimit mujor “Anketa e strukturave akomoduese”³. Objekt i këtij vrojtimi janë hotelet dhe strukturat e tjera të ngjashme me to që kanë kryer aktivitete turistike gjatë muajit referues për të cilin kryhet anketimi.

2. ANKETA E STRUKTURAVE AKOMODUESE, METODOLOGJIA E MBLEDHJES DHE PËRPUNIMIT TË TREGUESVE

2.1 Sistemi i klasifikimit

Rëndësia e klasifikimeve për politikën e turizmit (por edhe më konkretisht për politikën e zhvillimit rural ose politikën detare) është e qartë që në paragrafin e parë të Komunikatës së Komisionit të vitit 2010 COM(2010)352 “Evropa, destinacioni numër 1 turistik në botë - një i ri kuadri politik për turizmin në Evropë”⁶¹: “Turizmi është një aktivitet ekonomik i aftë për të gjeneruar rritje dhe punësim në BE, duke kontribuar në zhvillimin dhe integrimin ekonomik dhe social, veçanërisht të zonave rurale dhe malore, rajoneve bregdetare dhe jo-bregdetare, etj. Klasifikimet e përdorura për hartimin e statistikave të turizmit nga ana e ofertës janë: Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2); Nomenklaturën e njësive territoriale për statistikave (NUTS II); Zonat e afërsisë me bregdetin (zona bregdetare dhe jo-bregdetare).

NVE Rev. 2

Strukturat akomoduese turistike klasifikohen dhe përshkruhen në grupe sipas klasifikimit NVE Rev. 2 si vijon:

55.1 Hotele dhe akomodime të ngjashme. Kjo klasë përfshin: hotele, resort hotelier (kompleks turistik), hotel suite / apartament, motele.

55.2 Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime afatshkurtra. Kjo klasë përfshin: shtëpi pushimi për fëmijë dhe të tjerë, apartamente dhe shtëpi njëkatëshe për vizitorë, shtëpi pushimi familjare pa shërbim në dhomë, bujtina të rinjsh dhe streha malore.

55.3 Hapësirat për kampingje dhe për parqe, për çadra ose rulota argëtimi. Kjo klasë përfshin kampingje e parqe për

3. Anketa e Strukturave Akomoduese (tour_occ), Metadata Referenciale, 2019

çadra, automjete ose rulota për vizitorët me qëndrim të shkurtër.

NUTS II

Rajonet statistikore në nivelin 1, 2 dhe 3 përcaktohen sipas ndarjes territoriale NUTS II, i cili është një klasifikim i unifikuar dhe përdoret si bazë për mbledhjen dhe përpunimin e Statistikave Rajonale Evropiane. Informacioni më poshtë përfshin se cilat prefektura janë në rajonin e Veriut, Qendrës dhe Jugut.

Rajoni i Veriut (AL01): Dibër; Durrës; Kukës; Lezhë; Shkodër

Rajoni Qendër (AL02): Elbasan; Tiranë

Rajoni i Jugut (AL03): Berat; Fier; Gjirokastrë; Korçë; Vlorë

Zonat bregdetare

Zonat bregdetare janë Njësi Administrative Vendore (LAU) që janë në kufi ose afër një vijë bregdetare. Zonat bregdetare klasifikohen sipas dy kategorive të mëposhtme:

Zonat bregdetare: LAU që kufizohen me vijën bregdetare ose LAU që kanë të paktën 50% të sipërfaqes së tyre në një distancë prej 10 km nga vija bregdetare;

Zonat jo-bregdetare: LAU që nuk janë “zona bregdetare”; që nënkupton LAU që nuk kufizohen me vijën bregdetare dhe kanë më pak se 50% të sipërfaqes së tyre në një distancë prej 10 km nga vija bregdetare.

2.2 Projektimi i kampionimit

Në anketën e strukturave akomoduese përfshihen të gjitha strukturat akomoduese turistike nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve i dy viteve para vitit referencë (V-2). Strukturat e akomodimit turistik klasifikohen dhe përshkruhen në grupe sipas Klasifikimit NVE Rev. 2 si më poshtë:

55.1 (hotele dhe akomodime të ngjashme);

55.2 (akomodime për pushime dhe të tjera akomodime afatshkurtra);

55.3 (hapësirat për kampingje dhe për parqe, për çadra ose rulota argëtimi);

Bazë e zgjedhjes së të dhënave shërben regjistri statistikor i ndërmarrjeve, nga i cili përzgjidhen:

- Të gjitha ndërmarrjet me 10 ose më shumë të punësuar;
- Për ndërmarrjet e vogla, merret një kampion, duke përdorur shtresëzimin sipas madhësisë së ndërmarrjes dhe NVE. Sipas Rregullores 692/2011, NACE 55.1, 55.2 dhe 55.3 janë të mbuluara;
- *Metoda e përzgjedhjes së kampionit* - Marrja e mostrave të rastësishme sistematike të stratifikuar (SSRS).


2.3 Treguesit

Rregullorja në lidhje me statistikat evropiane mbi turizmin mbulon:

- Turizmi i brendshëm, përsa i përket kapacitetit dhe shfrytëzimit të strukturave akomoduese turistike;
- Turizmi i brendshëm, përsa i përket netëve turistike të kaluara në akomodime pa qira;
- Turizmi kombëtar, përsa i përket kërkesës për turizëm, që ka të bëjë me pjesëmarrjen në turizëm dhe karakteristikat e udhëtimeve turistike dhe vizitorët;
- Turizmi kombëtar, përsa i përket kërkesës për turizëm, që ka të bëjë me karakteristikat e vizitorëve ditorë.

Informacioni që mblidhet nga “Anketa e strukturave akomoduese” përfshin treguesit e kapacitetit dhe treguesit e shfrytëzimit, të cilat paraqiten në Figurën 1.

Figura 1: Skema e statistikave të akomodimit nga ana e ofertës



Ku:

Struktura akomoduese në statistikën e akomodimit përfshin të gjitha njësitë e akomodimit turistik që ofrojnë, si një shërbim të paguar (çmimi mund të subvencionohet pjesërisht ose plotësisht), shërbime akomodimi afatshkurtra ose qëndrimi të shkurtër.

Dhomë: është njësi e përbërë nga një dhomë ose grupe dhomash të cilat janë të marra me qira nga vizitorët (turistët) si një e tërë (qira e pandashme).

Shtrat: përcaktohet nga numri i personave që mund të qëndrojnë gjatë natës në një shtrat, duke përfshirë shtretërit ekstra të vendosur sipas kërkesës së vizitorit.

Vizitorë: është përcaktuar si një person i cili qëndron të paktën një natë në hotel duke përfshirë edhe fëmijët.

Rezident: konsiderohet ai person që ka banuar në Shqipëri për më shumë se 12 muaj radhazi.

Jo-Rezident: konsiderohet ai person që nuk ka banuar në Shqipëri për më shumë se 12 muaj radhazi.

Netë qëndrimi: është çdo natë që një vizitor / turist (rezident ose jo-rezident) shpenzon (fle apo qëndron) në një njësi akomodimi.

Dy tregues të rëndësishëm janë edhe normat neto të shfrytëzimit të shtretërve e dhomave. Sipas rregullores, këto dy tregues kanë kuptim vetëm për NVE 55.1 “Hotelet dhe akomodime të ngjashme”, sepse konsideron si strukturat me numër dhomash e shtretërish më të qëndrueshëm se dy klasat e tjera NVE 55.2 dhe 55.3. Quhen neto sepse llogariten në total për NVE 55.1, pa marrë parasysh vendodhjen e strukturës akomoduese sipas rajonit, afërsisë me bregdetin apo lloj tjetër klasifikimi territorial.

$$\text{Norma neto e shfrytëzimit të shtretërve} = \frac{\text{Numri i netë qëndrimeve}}{\text{Numri i shtretërve të disponueshëm}} * 100$$

që mat shkallën e shfrytëzimit të shtretërve për “Hotelet dhe akomodime të ngjashme” në përqindje. ku:

“Numri i netë qëndrimeve” është shuma e netë qëndrimeve gjatë periudhës referencë. Një netë qëndrimi është i barabartë me një shtrat të zënë.

“Numri i shtretërve të disponueshëm” shuma e shtretërve në ditë, gjatë periudhës referencë.

$$\text{Norma neto e shfrytëzimit të dhomave} = \frac{\text{Numri i dhomave të zëna}}{\text{Numri i dhomave të disponueshme}} * 100$$

që mat shkallën e shfrytëzimit të dhomave për “Hotelet dhe akomodime të ngjashme” në përqindje. ku:

“Numri i dhomave të zëna” Shuma e dhomave në përdorim gjatë periudhës referencë.

“Numri i dhomave të disponueshëm» shuma e dhomave në ditë, gjatë periudhës referencë.

2.4 Analiza dhe vlefshmëria e të dhënave

Gjatë hartimit të kontrolleve për vlefshmërinë e të dhënave është përdorur si referencë manuali i Eurostat-it për transmetimin e rezultateve, i cili përcakton një seri kontrollesh që janë aplikuar në tabelat mujore dhe vjetore të transmetimit të të dhënave. Këto rregulla përcaktojnë gjithashtu të gjitha indikatorët që duhen mbledhur. Bazuar në këto rregulla, realizohen një numër kontrollesh të cilat aplikohen në nivel mikro në grupin e të dhënave të anketës para përpilimit të rezultateve. Kontrollat “ndër-sektoriale” janë ato kontrolle logjike që realizohen ndërmjet përgjigjeve të një njësie në periudhën e referencës. Kontrollat “gjatësore” janë ato kontrolle që realizohen nga krahasimi i bazës së të dhënave mujore aktuale me grupet e të dhënave të muajve të mëparshëm.

Çdo mospërputhje që mund të ndikojë në rezultatet përfundimtare verifikohet dhe dokumentohet në bazën e të dhënave përfundimtare. Gjatë kësaj faze është e rëndësishme qëndrueshmëria midis të dhënave mujore. Për më tepër, çdo informacion jo-konsistent dhe i paverifikueshëm, fshihet dhe imputohet në hapat pasues duke përdorur algoritme të përshtatshme matematikore.

2.5 Metodologjia e peshimit

Informacioni në lidhje me njësitë që nuk përgjigjen me 10+ punonjës imputohet. Pësia nuk rekomandohet në këto raste. Këtyre njërive u jepet një peshë prej 1. Peshimi pas shtresëzimit duhet të bëhet për të kompensuar mospërgjigjen e njërive në mes njërive me 1-9 punonjës. Variablat e mëposhtëm përdoren për post-shtresëzim:

- Grupet e punësimit: 1-9 të punësuar; 10+ të punësuar
- Bregdetare / Jo-bregdetare⁴
- Rajoni

4. Strukturat Akomoduese Tremujori II 2021, fq. 6.

Metoda e propozuar siguron qëndrueshmëri përgjatë muajve pasi peshimi aplikohet vetëm në njësitë të cilat supozohet të kenë kapacitete relativisht të ulëta.

2.6 Trajtimi i njësive pa përgjigje

Duke pasur parasysh që prania e njësive pa përgjigje nuk mund të shmanget në vrojtime të tilla, janë zhvilluar procedura standarde për t'u marrë me këto probleme:

- Numri i dhomave të fjetjes: Të dhënat që mungojnë duhet të imputohen së pari nga burimet e të dhënave ndihmëse (p.sh. informacioni i mbledhur nga vërtetimet në periudhat e mëparshme ose informacione ndihmëse). Sa herë që kjo nuk është e mundur (veçanërisht për muajin e parë të grumbullimit të të dhënave), atëherë këto të dhëna imputohen përmes modeleve statistikore të bazuara në korrelacionin midis punësimit dhe kapacitetit të akomodimit në turizëm.
- Numri i shtretërve: Ky variabël duhet të llogaritet nga informacioni i mbledhur nga muajt e mëparshëm të anketës, ose përndryshe përmes një raporti (p.sh. numri mesatar i shtretërve për dhomë) të llogaritur duke përdorur një teknikë të përshtatshme statistikore (hot-deck imputation).
- Numri i përgjithshëm i vizitorëve: Informacioni i munguar për vizitorët duhet të imputohet bazuar në të dhënat e muajve të mëparshëm, të përditësuara përmes raporteve të vlerësuara nga njësitë e tjera të përgjigjura me karakteristika të njëjta (p.sh. bregdetare/jo-bregdetare, rajoni, grupi i punësimit dhe NVE).
- Numri i netë qëndrimeve: Informacioni që mungon në këtë variabël imputohet nga kohëzgjatja mesatare e qëndrimit, e llogaritur nga njësitë me karakteristika të ngjashme që përgjigjen.
- Shpërndarja e të dhënave të shfrytëzimit: Të dhënat e imputuara për vizitorët dhe netët e qëndrimeve mund të 'ndahen' në mikro-nivel sipas statusit të qëndrimit dhe kombësisë së vizitorëve, bazuar në raportet e llogaritura nga njësitë e përgjigjura me karakteristika të ngjashme.

3. REZULTATE

Shqipëria ka njohur rritje të numrit të vizitorëve dhe netë qëndrimeve gjatë viteve para pandemike sic përshkruhet edhe në raportin e Konkurrueshmërisë në Evropën Juglindore (OECD, 2021). Sipas këtij raporti, Ballkani Perëndimor ku bën pjesë edhe vendi ynë është një nga rajonet turistike me rritjen më të shpejtë në botë, me të gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor (BB6) që kanë parë rritje dyshifrore në ardhjet dhe qëndrimet turistike në vitet e fundit. Rritja e shpejtë e vizitorëve turistikë kontribuon në rritjen e të ardhurave, produktit të brendshëm bruto (PBB), eksporteve dhe krijimit të vendeve të punës, duke nënvizuar rëndësinë në rritje të sektorit për zhvillimin rajonal.

Rezultatet e Anketës së Strukturave Akomoduese janë të disponueshme nisur nga Janari i vitit 2018. Në këtë studim do analizohet seria kohore me të dhëna vjetore nga viti 2018 deri në vitin 2021. Viti 2020 njihet si viti kulmor i pandemisë globale COVID 19, gjendje me të cilën u sfidua edhe vendi ynë. Kjo situatë pati impaktin e vet në çdo sektor të ekonomisë dhe ndikimi negativ përfshiu ndjeshëm edhe sektorin e turizmit. Viti 2020 duhet interpretuar si rënie në kontekst të situatës së COVID 19.

3.1 Treguesit e kapacitetit akomodues

Në vitin 2021 numri i strukturave akomoduese të vërtetuara ka pësuar një rënie të lehtë me 0,8 % krahasuar me vitin 2020, dhe është rritur me 9,9 % krahasuar me vitin 2019. Numri i dhomave në strukturat akomoduese është rritur me 3,8 % krahasuar me vitin 2020, ndërsa krahasuar me vitin 2019 ky tregues është rritur me 7,8 %. Numri

i shtretërve në vitin 2021 është rritur me 3,3 % krahasuar me vitin 2020, dhe është rritur me 10,6 % krahasuar me vitin 2019.

Tabela 1: Kapaciteti akomodues, 2018 – 2021

Viti	NVE Rev. 2			
	55.1	55.2	55.3	Gjithsej
Numri i strukturave akomoduese				
2018	1.021	268	37	1.326
2019	1.126	208	71	1.405
2020	1.237	177	55	1.469
2021	1.256	145	56	1.457
Numri i dhomave				
2018	30.524	3.703	293	34.520
2019	33.798	3.607	629	38.034
2020	34.713	4.230	587	39.530
2021	35.802	4.621	596	41.019
Numri i shtretërve				
2018	69.395	9.478	685	79.558
2019	77.974	9.574	1.399	88.947
2020	82.434	11.327	1.481	95.242
2021	85.403	11.393	1.571	98.367

Burimi: INSTAT

3.2 Treguesit e shfrytëzimit të kapacitetit akomodues

Gjatë vitit 2021 numri i vizitorëve është rritur me 85,1 % krahasuar me vitin 2020, ndërkohë ka rënë me 1,8 % krahasuar me vitin 2019 (shih tabelën 2).

Numri i netë qëndrimeve gjatë vitit 2021 është rritur me 98,5 % krahasuar me vitin 2020. Ky tregues ka pësuar rënie me 2,1 % krahasuar me vitin 2019.

Gjatë vitit 2021 numri mesatar i netë qëndrimeve që një vizitor ka kaluar në strukturat akomoduese është 2,6 netë qëndrime, në vitin 2020 është 2,4 netë qëndrime dhe në vitin 2019 është 2,6 netë qëndrime (shih Tabelën 3).

Tabela 2: Numri i vizitorëve në strukturat akomoduese, 2018 – 2021

Viti	NUTS II			Zonat bregdetare		NVE Rev. 2			
	AL01	AL02	AL03	Bregdetare	Jo-bregdetare	55.1	55.2	55.3	Gjithsej
2018	291.011	468.692	483.058	521.885	720.876	1.111.687	119.023	12.051	1.242.761
2019	327.752	459.774	465.970	570.971	682.525	1.165.853	72.614	15.029	1.253.496
2020	128.178	245.508	291.494	367.135	298.045	630.344	29.151	5.685	665.180
2021	328.683	458.645	443.588	729.828	501.088	1.173.154	50.146	7.616	1.230.916


Burimi: INSTAT

Tabela 3: Numri i netë qëndrimeve në strukturat akomoduese, 2018 – 2021

Viti	NUTS II			Zonat bregdetare		NVE Rev. 2			
	AL01	AL02	AL03	Bregdetare	Jo-bregdetare	55.1	55.2	55.3	Gjithsej
Netë qëndrime									
2018	915.992	1.095.904	1.062.761	1.610.265	1.464.392	2.698.255	350.670	25.732	3.074.657
2019	1.078.360	1.076.512	1.098.547	1.913.448	1.339.971	3.002.289	221.669	29.461	3.253.419
2020	461.800	488.603	655.041	1.091.836	513.608	1.478.022	115.957	11.465	1.605.444
2021	825.761	1.145.547	1.214.764	2.381.810	804.262	3.008.704	158.222	19.146	3.186.072
Mesatarja e netëve									
2018	3,1	2,3	2,2	3,1	2,0	2,4	2,9	2,1	2,5
2019	3,3	2,3	2,4	3,4	2,0	2,6	3,1	2,0	2,6
2020	3,6	2,0	2,2	3,0	1,7	2,3	4,0	2,0	2,4
2021	2,5	2,5	2,7	3,3	1,6	2,6	3,2	2,5	2,6

Burimi: INSTAT

Gjatë vitit 2021, norma neto e shfrytëzimit të dhomave të “Hoteleve dhe akomodimeve të ngjashme” arrin në 17,5 %, kundrejt 10,6 % që ishte në vitin 2020 dhe 26,5 % që ishte në vitin 2019. Gjithashtu norma neto e shfrytëzimit të shtretërve të “Hoteleve dhe akomodimeve të ngjashme” shënon 17,0 % kundrejt 10,1 % që ishte në vitin 2020 dhe 24,4 % në vitin 2019 (shih Figurën 2).

Figura 2: Norma neto e shfrytëzimit në përqindje, 2018 - 2021

Burimi: INSTAT

3.3 Treguesit e lejeve të ndërtimit të miratuara për hotele dhe të ngjashme

Gjatë viteve 2018-2021 u miratuan 198 leje ndërtimi⁵ për “Hotele dhe të ngjashme” mesatarisht rreth 50 leje të miratuara për çdo vit. Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për “Hotele dhe të ngjashme” gjatë harkut kohor 2018-2021 ishte 762 mijë metra katrorë, ku viti 2019 shënoi vlerën më të lartë të këtij treguesi me përkatësisht 419 mijë metra katrorë të miratuara. Në vitin 2021, treguesit e numrit dhe sipërfaqes së lejeve të ndërtimit të miratuara paraqiten me rritje përkatësisht 43,5 % dhe 87,0 % krahasuar me vitin paraardhës. Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për “Hotele dhe të ngjashme” gjatë këtij katër-vjeçari ishte rreth 25.7 miliardë lekë. Në vitin 2021, ky tregues u paraqit me rritje prej 77,8 % krahasuar me vitin 2020 (shih Tabelën 4).


Tabela 4: Treguesit mbi lejet e ndërtimit të miratuara për “Hotele dhe të ngjashme”, 2018 – 2021

Treguesi	2018	2019	2020	2021
Numër	75	67	23	33
Sipërfaqja (000/m2)	122	419	77	144
Vlera e përafërt (Milionë/lekë)	3.771	13.785	2.915	5.183

Burimi: INSTAT

Gjatë viteve 2018-2021, lejet e ndërtimit “Hotele dhe të ngjashme” u përqendruan kryesisht në Rajonin e Jugut me 47,0 %, ndjekur nga Rajoni i Veriut me 29,8 % dhe Rajoni Qendër me 23,2 % (shih Figurën 3).

Figura 3: Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara për “Hotele dhe të ngjashme” sipas rajoneve, 2018-2021



Burimi: INSTAT

3.4 Treguesi i punësimit në industritë e turizmit

Të punësuarit në aktivitetin ekonomik të akomodimit gjatë viti 2020 zënë një peshë prej 20,0 % të të punësuarve gjithsej në industritë e turizmit. Gjatë vitit 2020 numri i të punësuarve në industritë e lidhura direkt me turizmin është 32.745 duke rënë me 21,0 %, ndërsa të punësuarit në aktivitetin ekonomik të akomodimit kanë rënë me 20,1 %, krahasuar me vitin 2019 (shih Tabelën 5).

5. Lejet e ndërtimit

Gjatë vitit 2019 numri i të punësuarve në industritë e lidhura direkt me turizmin është 41.439 duke u rritur me 13,4 %, ndërkohë të punësuarit në aktivitetin ekonomik të akomodimit janë rritur me 20,8 %, krahasuar me vitin 2018. Të punësuarit në aktivitetin ekonomik të akomodimit gjatë viti 2019 zënë një peshë prej 19,7 % të të punësuarve gjithsej në industritë e turizmit, kundrejt peshës prej 18,5 % që zinte në vitin 2018 (shih Tabelën 5).

Tabela 5: Numri i të punësuarve sipas industrive të turizmit

Viti	NVE 2-shifror			
	55.1-55.3	56.1-56.3	77.11-77.21; 79	Gjithsej
2018	6.770	27.392	2.371	36.533
2019	8.181	30.237	3.021	41.439
2020	6.535	24.029	2.181	32.745

Burimi: INSTAT, Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve⁶

*55.1-55.3 Akomodimi

**56.1-56.3 Shërbime ushqimi dhe pije (gjithsej)

***77.11-77.21; 79 Agjenci udhëtimi, operator turistik, qera e makinave dhe të tjera aktivitete të shërbimit të rezervimit (gjithsej)

4. KONKLUZIONE

Në konkluzionet e këtij artikulli vlen të përsëritet rëndësia e sektorit të turizmit dhe kontributi në rritje në ekonominë e vendit. Siç citohet edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, Shqipëria po rekomandohet gjithmonë e më shumë si destinacion turistik nga operatorë të ndryshëm turistikë ndërkombëtarë dhe nga guidat e udhëtimeve. Sektori i turizmit ka siguruar zhvillimin ekonomik, si edhe mundësi punësimi dhe vetë-punësimi. Gjithashtu, turizmi gjatë viteve të fundit është diversifikuar më shumë dhe tashmë përfshin tre fusha kryesore produktesh. E para është turizmi bregdetar ku produkti kryesor është turizmi “plazh dhe det”. Produkti i dytë është turizmi kulturor. Produkti i tretë është ekoturizmi - zonat natyrore dhe rurale. Pavarësisht situatës përgjithësisht pozitive mbeten disa sfida kryesore me të cilat përballlet sektori (SKZHI, 2016).

Për përballjen e këtyre sfidave dhe zhvillimin e sektorit të turizmit, qeveritë dhe vendimmarrësit hartojnë politika dhe strategji zhvillimi. Prandaj është e nevojshme matja e ndikimit dhe hulumtimi sasior i tij. Sot ekzistojnë metoda të ndryshme të mbledhjes së të dhënave dhe dokumenteve të ndryshme të publikuara në lidhje me statistikën e turizmit nga institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare. Niveli kombëtar përfaqësohet nga zyrat kombëtare të statistikave dhe në rastin e Shqipërisë është Instituti i Statistikave (INSTAT), ndërsa në nivelin ndërkombëtar me zyrën statistikore të Bashkimit Evropian - Eurostat dhe organizatat joqeveritare - Organizata Botërore e Turizmit (UNWTO) dhe Këshilli Botëror i Udhëtimit dhe Turizmit (WTTC) (Gajdošik, T., dhe Gajdošiková, Z., 2016). Informacioni statistikor mbi sektorin e turizmit në tërësi, dhe statistikën e akomodimit nga ana e ofertës që u shqyrtuan në këtë artikull shërbejnë si bazë themelore për hartimin e politikave dhe strategjive të zhvillimit në vend. Për më shumë, duke prodhuar statistika të akomodimit nga ana e ofertës të harmonizuara sipas standarteve evropiane, ky informacion bëhet gjerësisht i krahasueshëm në nivel evropian dhe botëror, duke i shërbyer zhvillimit strategjik të rajoneve ku Shqipëria bën pjesë.

6. Rezultate të anketës strukturore të ndërmarrjeve ekonomike 2019.

REFERENCA

- [1] Anketa e Strukturave Akomoduese (tour_occ), Metadata Referenciale, 2019.
http://www.instat.gov.al/media/7753/36-anketa-e-strukturave-akomoduese_esms_final_al.pdf
- [2] Gajdošík, T., dhe Gajdošíková, Z., (2016), *Current challenges in tourism statistics: Tourism economic importance measurement*. International Scientific Conference FERNSTAT 2016. Banská Bystrica, Slovakia 22 Sep 2016 – 23 Sep 2016.
https://www.researchgate.net/publication/330957641_CURRENT_CHALLENGES_IN TOURISM STATISTICS TOURISM ECONOMIC IMPORTANCE MEASUREMENT
- [3] Instituti i Statistikave, (2021), *Shqipëria në shifra 2020*. Tiranë, Shqipëri: Instituti i Statistikave.
<http://www.instat.gov.al/media/8986/shqiperia-ne-shifra-2020.pdf>
- [4] Lejet e ndërtimit.
<http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/nd%C3%ABrtimi/#tab3>
- [5] OECD (2021), *Competitiveness in South East Europe 2021: A Policy Outlook, Competitiveness and Private Sector Development*, OECD Publishing, Paris.
<https://doi.org/10.1787/dcbc2ea9-en>.
- [6] Rezultate të anketës strukturore të ndërmarrjeve ekonomike 2019.
http://www.instat.gov.al/media/8365/materiali-shkrimor-asn-2019_11022021_last.pdf
- [7] Rregullorja (BE) Nr. 692/ 2011 e Bashkimit Evropian dhe Këshillit Evropian.
<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32011R0692&from=EN>
- [8] Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020.
https://www.mod.gov.al/images/PDF/strategji2016/SKZHI_FINAL_QBZ.pdf
- [9] Strategjia kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit 2019 – 2023, MTM.
<http://www.turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Komb%C3%ABtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>
- [10] Strukturat Akomoduese Tremujori II 2021, fq. 6.
http://www.instat.gov.al/media/8806/strukturat-akomoduese-t2-2021____.pdf
- [11] Turizmi, INSTAT.
<http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/turizmi/#tab3>
- [12] Udhëzuesi metodologjik i statistikave të turizmit, EUROSTAT.
<https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3859598/6454997/KS-GQ-14-013-EN-N.pdf/166605aa-c990-40c4-b9f7-59c297154277?t=1420557603000>
- [13] World Tourism Organization (2019), *Methodological Notes to the Tourism Statistics Database*, 2019 Edition, UNWTO, Madrid.
<https://doi.org/10.18111/9789284420476>

NDIKIMI I PANDEMISË NË SJELLJEN E BIZNESIT NË VITE

Autorët:

FLUTURA RAMA (frama@instat.gov.al)

KOZETA HAXHILLARI (khaxhillari@instat.gov.al)

Abstrakt

Viti 2020 do të shënonte një kthesë të fortë në mbarë botën, fillimin e një historie krejt të panjohur për kohët moderne, një histori që do të ndryshonte rrënjësisht mënyrën e të jetuarit, një histori që vazhdon ende sot dhe fundi duket jo shumë pranë. Covid-19 vazhdon të shënojë të infektuar dhe humbje jete si dhe të sjellë kaos në ekonominë botërore. Të jetuarit me të u bë një domosdoshmëri dhe e vetmja mënyrë për të mbijetuar dhe siguruar mbarëvajtjen në familje dhe në biznes.

Por çfarë po ndodh me ekonominë e brishtë shqiptare? Çfarë ndodh me bizneset e konsoliduara dhe me bizneset e reja të krijuara gjatë kësaj periudhe? Çfarë ndodh me aktivitetin e tyre ekonomik, ka mbetur i njëjtë apo ka ndryshuar në funksion të përshtatjes me situatën e pandemisë?

Qëllimi i këtij studimi është të identifikojë sjelljen e biznesit para dhe gjatë Covid-19 si dhe të sjellë një tablo të qartë të ndërmarrjeve në vend.

Regjistrat e Biznesit për vitet 2018-2021 do të shërbejnë si mjet kryesor në këtë studim, ku burimet administrative kanë kontributin më të rëndësishëm për përditësimin e tyre.

Fjalë kyçe:

Regjistrat e Biznesit; Pandemia; Ndërmarrja; Burim Administrativ; Aktiviteti Ekonomik.

1. NDËRMARRJE AKTIVE GJITHSEJ DHE NDËRMARRJE TË KRIJUARA GJATË NJË VITI

Covid-19 erdhi si një fenomen krejt i panjohur për kohët moderne mirëpo pasojat e tij u panë menjëherë e nuk ngjasonin me asnjë krizë tjetër më parë. Mbyllja e dyqaneve dhe shkollave, mbyllja e kufijve dhe vendosja e gjysmës së njerëzimit nën një formë bllokimi tregoi qartë që do shkundte ndjeshëm dhe themelet e ekonomisë botërore.


Dy vjet pas pandemisë, efektet sociale dhe ekonomike ndihen ende mbi shtete dhe ekonomitë e tyre. Mënyra e të menduarit dhe të vepruarit si në aspektin familjar dhe në atë të sipërmarrjes mori një kthesë të fortë ku pasiguria zuri një vend të rëndësishëm.

Viti 2019 mbyllet me një fatkeqësi natyrore, tërmetin e 26 Nëntorit i cili gjithashtu pati një impakt në shumë biznese ambjentet e të cilave u dëmtuan e si pasojë dhe aktiviteti i tyre u ndërpre në një afat të pacaktuar. Më tej, në muajt e parë të vitit 2020, pasojave të tërmetit do t'i mbivendosej dhe fillimi i pandemisë së Covid 19.

Për sa më lartë, studimi është fokusuar kryesisht në vitet 2018-2021. Ky hark kohor është marrë në konsideratë duke u bazuar dhe në tiparet e ndryshme që këto vite kanë. Teorikisht viti 2018 karakterizohet nga një qëndrueshmëri në ekonomi pra pa ndonjë faktor (zhvillues ose ndikues) ndaj krijimit të bizneseve të reja ose mbylljes së tyre. Ndërkohë që viti 2020 shfaqet si një vit i brishtë në të cilin ecin paralelisht pasojat e tërmetit dhe fillimi i pandemisë.

Figura 1 paraqet numrin e ndërmarrjeve gjithsej gjatë një viti si dhe ndërmarrjet e reja të krijuara (në %). E thënë ndryshe, shkalla e lindjes së ndërmarrjeve është raporti i ndërmarrjeve të reja të krijuara gjatë një viti ndaj numrit të ndërmarrjeve gjithsej po në të njëjtin vit.

Figura 1 Ndërmarrje gjithsej dhe ndërmarrje të reja krijuar gjatë vitit, 2018-2021



Burimi: INSTAT, 2018-2021

Numri i ndërmarrjeve aktive në fund të vitit 2018 ishte 121.882 (përfshirë fermerët) ndërkohë që lindshmëria po në të njëjtin vit ishte 12,4%. Gjatë vitit 2020 shohim një ulje të numrit të ndërmarrjeve gjithsej si dhe të ndërmarrjeve të krijuara po në të njëjtin vit, pra kemi një rënie në krijimin e ndërmarrjeve të reja me 10,5% si dhe në numrin e ndërmarrjeve gjithsej aktive në fund të vitit me 117.333.

Viti 2021 vjen me një përmirësim të situatës në lidhje me sipërmarrësit e rinj që vendosën të hapnin një aktivitet ekonomik për herë të parë. Ndërmarrjet e reja të krijuara zënë 12,6% ndaj numrit të ndërmarrjeve gjithsej aktive në fund të vitit 2021 numër ky pothuajse i njëjtë me periudhën para pandemisë, pra vitin 2019. Gjithashtu dhe numri i ndërmarrjeve gjithsej ka pësuar një rritje me 1,1% krahasuar me vitin 2020.


2. AKTIVITETI EKONOMIK I NDËRMARRJEVE

Aktiviteti ekonomik është i pranishëm pothuajse në të gjitha aspektet e shoqërisë. Çdo dyqan, restorant, pothuajse çdo mall apo shërbim në mënyrë që të gjenerojë një fitim duhet të kryejë një aktivitet ekonomik. Aktiviteti ekonomik që ndërmarrja kryen është një tregues mjaft i rëndësishëm për të grupuar dhe sektorin ku ato operojnë, në prodhues apo shërbime.

Figura 2 paraqet shpërndarjen e ndërmarrjeve të reja sipas aktivitetit ekonomik. Në vitin 2018 aktivitetet “Tregti”, “Shërbime të tjera” si dhe “Akomodimi dhe shërbimi ushqimor” kanë qenë aktivitetet më të preferuara për sipërmarrësit e rinj duke zënë një përqindje të konsiderueshme përkatësisht me 80,5% ndaj ndërmarrjeve të reja gjithsej. Situata mbetet e njëjtë për vitet në vijim, pra këto aktivitete mbeten më të preferuarat. Gjatë vitit 2020 ndërmarrjet e reja në aktivitetin “Akomodim dhe shërbim ushqimor” zinin vetëm 14,3% ndaj totalit të ndërmarrjeve gjithsej të reja krahasuar me 19,4% në vitin 2019.

Aktiviteti ekonomik “Ndërtim” gjatë vitit 2020 ka pësuar një rritje krahasuar me vitin 2019, përkatësisht nga 4,2% në 7,0%.

Figura 2 Ndërmarrjet e reja sipas aktivitetit ekonomik, 2018-2021



Sot jemi dëshmitarë të zhvillimeve në fushën e shkencës dhe teknologjisë. Shek. XXI konsiderohet si shekulli i teknologjisë ku secili prej nesh po bëhet gjithmonë e më i varur nga ky zhvillim. Tashmë teknologjia po bëhet mjete ynë i komunikimit, i informacionit, i kënaqësisë, i argëtimit, i sigurisë, i shëndetit, pra në një farë mënyre mbulon të gjitha sferat më të rëndësishme të jetës.

Shumë zhvillime teknologjike tashmë janë pjesë e përditshmërisë sonë si p.sh: kompjuterët, tabletët, telefonat smart, pajisjet e ndryshme elektronike, zhvillimi i internetit, zhvillimi i teknologjisë së mjekësisë e shumë tjera. Numri i ndërmarrjeve të reja të krijuara në aktivitetin “Informacion dhe Komunikacion” gjatë vitit 2021 është rritur ndjeshëm krahasuar me vitin 2018, nga 4,2% në 8,4%. Rritja ka qenë konstante çdo vit.

Sektori i industrisë ka ndikimin më të madh në grupin “Prodhues të të mirave”. Në vitin 2018 numri i ndërmarrjeve që operonin në aktivitetin “Industri” zinte 64,0% të grupit të “Prodhuesve të të mirave”. Ndërkohë që gjatë vitit 2021 numri i ndërmarrjeve në po të njëjtin aktivitet zë 56,6% të grupit të “Prodhuesve të të mirave”.


Tabela 1 Ndërmarrje aktive gjithsej sipas aktivitetit ekonomik, 2018-2021

Viti	2018	2019	2020	2021
Gjithsej	121.882	117.869	117.333	118.627
Prodhues të të mirave	15.963	15.588	15.989	15.876
Bujqësia pyjet dhe peshkimi	1.146	1.232	1.358	1.354
Industria	10.215	9.630	9.571	8.991
Ndërtimi	4.602	4.726	5.060	5.531
Prodhues të shërbimeve	105.919	102.281	101.344	102.751
Tregtia	46.643	44.324	43.668	42.995
Transporti e Magazini	5.765	5.614	5.708	5.689
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	20.185	18.440	17.713	17.121
Informacioni e Komunikacioni	2.974	3.089	3.349	4.005
Shërbime të tjera	30.352	30.814	30.906	32.941

Burimi: INSTAT, 2018-2021

Ekonomia shqiptare në tërësi është fokusuar kryesisht në aktivitet “Tregti”, “Akomodim dhe shërbim ushqimor” si dhe në “Shërbime të tjera”. Figura 3 paraqet shpërndarjen ndërmarrjeve gjithsej që ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik brenda territorit të Shqipërisë gjatë viteve 2018-2021.

Figura 3 Shpërndarja e ndërmarrjeve gjithsej sipas aktiviteti ekonomik, 2018-2021




Burimi: INSTAT, 2018-2021

3. NDËRMARRJET SIPAS MADHËSISË SË TYRE

Në aspektin e madhësisë së ndërmarrjes ose numrit të të punësuarve gjithsej që një ndërmarrje zotëron situata paraqitet në figurën 4. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme zënë 98,4% të bizneseve në vend për vitin 2018 dhe situata paraqitet pothuajse e njëjtë për vitet pasardhëse në po të njëjtin grup.

Ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar përfaqësojnë 1,6% të ndërmarrjeve gjithsej në Shqipëri për vitin 2018 dhe situata mbetet pothuajse e njëjtë dhe në vitet në vijim, 2019-2021. Ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar dukshëm zënë një përqindje të vogël në numër, por kontributi i tyre në punësim është i madh. Në vitin 2021 kontributi në punësim i ndërmarrjeve me 50 e më shumë të punësuar është 51,1%.

Figura 4 Ndërmarrje aktive gjithsej sipas madhësisë, 2018-2021


Burimi: INSTAT, 2018-2021


Tabela 2 paraqet shpërndarjen e ndërmarrjeve të reja sipas madhësisë së tyre dhe aktivitetit ekonomik. Në vitin 2020 grupi i ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha (me mbi 10 të punësuar) përfaqësonte 0,5% ndaj totalit të ndërmarrjeve të reja krahasuar me 3,1% që ishte në vitin 2019 dhe 3,0% gjatë vitit 2018 (Shih grafikun 5).

Tabela 2 Ndërmarrje të reja sipas madhësisë dhe aktivitetit ekonomik

Madhësia ndërmarrjes	2018		Gjithsej 2018	2019		Gjithsej 2019
	Prodhuetit e të mirave	Prodhuetit e shërbimeve		Prodhuetit e të mirave	Prodhuetit e shërbimeve	
Gjithsej	1.610	13.549	15.159	1.435	12.080	13.515
01-04	1.381	12.567	13.948	1.162	11.027	12.189
05-09	123	639	762	176	729	905
10+	106	343	449	97	324	421

Madhësia ndërmarrjes	2020		Gjithsej 2020	2021		Gjithsej 2021
	Prodhuetit e të mirave	Prodhuetit e shërbimeve		Prodhuetit e të mirave	Prodhuetit e shërbimeve	
Gjithsej	1.913	10.679	12.592	1.951	12.995	14.946
01-04	1.873	10.580	12.453	1.664	12.158	13.822
05-09	22	59	81	177	512	689
10+	18	40	58	110	325	435

Figura 5 Ndërmarrje të mesme dhe të mëdha (të reja)




4. NDËRMARRJET SIPAS QARQEVE

Gjatë vitit 2018, qarqet Tiranë, Durrës, Fier dhe Vlorë ishin qarqet me përqendrimin më të lartë të ndërmarrjeve gjithsej, si dhe të ndërmarrjeve të reja të krijuara. Rreth 77,5% e ndërmarrjeve të reja u regjistruan pikërisht në qarqet e cituara më lart. Qarqet me përqendrimin më të vogël të ndërmarrjeve janë qarku i Kukësit dhe Dibrës.

Për nga ndarja rajonale, Rajoni II është rajoni më i zhvilluar. Në vitin 2021, 52,4% e aktivitetit ekonomik në rang vendit u përqëndrua pikërisht në Rajonin II, krahasuar me 51,3% që ishte në vitin 2019.

Tabela 3 Ndërmarrje gjithsej dhe të reja sipas ndarjes territoriale NUTS III, 2018-2021

Rajonet	2018		2019		2020		2021	
	Gjithsej	Të reja	Gjithsej	Të reja	Gjithsej	Të reja	Gjithsej	Të reja
Shqipëria	121.882	15.159	117.869	13.515	117.333	12.376	118.627	14.946
Rajoni I	27.616	3.034	26.159	2.517	25.738	2.442	25.639	2.744
Dibër	2.339	180	2.258	148	2.224	147	2.185	172
Durrës	12.333	1.584	11.849	1.277	11.890	1.243	11.910	1.373
Kukës	1.266	113	1.256	121	1.253	106	1.261	132
Lezhë	4.431	467	4.097	395	4.126	394	4.126	457
Shkodër	7.247	690	6.699	576	6.245	552	6.157	610
Rajoni II	60.619	8.865	59.801	8.015	60.136	7.275	62.219	9.180
Elbasan	8.361	779	7.863	646	7.805	633	7.578	689
Tiranë	52.258	8.086	51.938	7.369	52.331	6.642	54.641	8.491
Rajoni III	33.647	3.260	31.909	2.983	31.459	2.659	30.769	3.022
Berat	4.323	317	4.129	336	4.086	300	3.886	323
Fier	10.471	975	9.873	795	9.726	788	9.443	894
Gjirokastrë	2.753	213	2.611	170	2.537	144	2.464	187
Korçë	6.705	686	6.499	719	6.355	569	6.105	558
Vlorë	9.395	1.069	8.797	963	8.755	858	8.871	1.060

Figura 6 Ndërmarrje gjithsej sipas ndarjes territoriale NUTS III, 2018–2021 (%)

KONKLUZIONE

Si në çdo ekonomi tjetër në botë, edhe në Shqipëri pandemia e COVID-19 do të kishte një ndikim të thellë dhe të ndjeshëm, si në aspektin individual dhe në atë të sipërmarrjes. Ndalimi i motorrit të ekonomisë në çdo sektorë të saj ishte një stopim i plotë si në shërbime ashtu dhe në prodhim. Struktura ekonomike e Shqipërisë, e bazuar fort në shërbime, ndryshe nga ekonomitë që një pjesë të mirë të saj e përbën sektori i prodhimit dhe bujqësia u besua që në fillim se do të goditej më fortë. Konkretisht, sektorët më të prekur dhe të goditur në ekonominë e Shqipërisë do të ishin: hotelieri-turizmi, shërbimet tregtare (bar-kafe, restorante), sektori i argëtimit, por dhe fasoneritë etj.

Lexuesi në këtë artikull informues u prezantua mbi situatën e biznesit bazuar tërësisht në informacionin që *Regjistrat e Biznesit* përmbajnë.

Regjistrat e Biznesit mirëmbahen dhe përditësohen pranë Institutit të Statistikave (INSTAT) që prej vitit 1998. Burimi administrativ dhe vërtetimet statistikore janë mjeti kryesor që bëjnë të mundur kryerjen e procesit të përditësimit. Kërkesa gjithnjë e në rritje e përdoruesve për statistika të një cilësie të lartë ka sjellë dhe rritjen e përgjegjshmërisë ose detyrimin që INSTAT ka për plotësimin me rigorozitet të nevojave të përdoruesve.

Prej vitesh INSTAT bashkëpunon me shumë efikasitet nëpërmjet memorandumeve me institucione si: *Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)*, *Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)* etj. Përgjatë viteve cilësia e burimit administrativ është përmirësuar ndjeshëm dhe kjo ka ndikuar direkt në përmirësimin e cilësisë së regjistrave të biznesit si shtylla kryesore e statistikave ekonomike pranë INSTAT.

METODOLOGJIA

Regjistrat e Biznesit përmbajnë të gjitha njësitë ligjore, ndërmarrjet, aktivitetet ekonomike e të cilave kontribuojnë në Prodhimin e Brendshëm Bruto (P.B.B) dhe të gjitha njësitë lokale të tyre. Statusi i ndërmarrjes është një variabël pjesë e regjistrave të biznesit i cili përditësohet çdo vit me anë të burimeve administrative si dhe të vrojtimit statistikor të zhvilluara nga Instituti i Statistikave, INSTAT.

Ndërmarrja si koncept është: "kombinimi më i vogël i njërive ligjore pra një njësi organizative e cila prodhon të mira apo shërbime dhe ka një farë autonomie në marrjen e vendimeve, veçanërisht për shpërndarjen e burimeve aktuale të saj. Ndërmarrja kryen një ose me shumë aktivitete në një apo më shumë vendndodhje (njësi lokale)".

Një aktivitet ekonomik ndodh kur burime të tilla si mallrat kapitale, puna, teknikat e prodhimit ose produktet ndërmjetës janë të kombinuara për të prodhuar mallra ose shërbime specifike. Kështu, një aktivitet ekonomik është i karakterizuar nga një kontribut i burimeve, një proces të prodhimit dhe një prodhim të produkteve (mallra ose shërbime).

Nomenklatura e veprimtarive ekonomike (NVE) përdoret për të përcaktuar klasifikimet e ndryshme statistikore të aktiviteteve ekonomike të zhvilluara që nga viti 1970 në Bashkimin Evropian. NVE ofron kornizën për mbledhjen dhe paraqitjen e një gamë të madhe statistikore. Krahueshmëria në nivel botëror të statistikave të prodhuara në bazë të NVE është për shkak të faktit se NVE është pjesë e një sistemi të integruar të klasifikimit statistikor, zhvilluar kryesisht nën kujdesin statistikor të Divizionit të Kombeve të Bashkuara.

Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE), është klasifikim në nivel katërshifror i veprimtarive ekonomike të ushtruara nga ndërmarrjet. Kjo nomenklaturë është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 320 datë 28.5.2014 dhe është përkthimi dhe përshtatja e Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike të Komunitetit Evropian NACE Rev. 2.

Madhësia e ndërmarrjes përcaktohet nga numri i të punësuarve. Ndërmarrjet me 1-4 të punësuar klasifikohen si ndërmarrje shumë të vogla; Ndërmarrjet me 5-9 të punësuar klasifikohen si ndërmarrje të vogla; Ndërmarrjet me 10-49 të punësuar klasifikohen si ndërmarrje të mesme; Ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar klasifikohen si ndërmarrje të mëdha.

Ndarja territoriale në 3 (tri) rajone NUTS II. Organizimi territorial statistikor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë përfshin tri rajone bazuar në qarqe:

- Rajoni I: Dibër, Durrës, Kukës, Lezhë, Shkodër;
- Rajoni II: Elbasan, Tiranë;
- Rajoni III: Berat, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Vlorë.

Referencat

- [1] [PxWeb - Select table \(instat.gov.al\)](#) – Databaza statistikore e Regjistrave të Biznesit
- [2] [Regjistrat e Biznesit, 2021 | Instat](#) – Publikimi i Regjistrave të Biznesit, 2021
- [3] [Regjistri i Ndërmarrjeve, 2020 | Instat](#) – Publikimi i Regjistrave të Biznesit, 2020
- [4] [Regjistri i Ndërmarrjeve, 2019 | Instat](#) – Publikimi i Regjistrave të Biznesit, 2019
- [5] [Regjistri i Ndërmarrjeve, 2018 | Instat](#) – Publikimi i Regjistrave të Biznesit, 2018

SI NDIKOJNË MASAT ADMINISTRATIVE TË MARRA NGA AUTORITETET RRUGORE NË NUMRIN E AKSIDENTEVE

Autorët:
IRSIDA NUELLARI
OLSA ULQINAKU

Abstrakt

Gjatë këtyre viteve, masat administrative të ndërmarra për qarkullimin e mjeteve të transportit rrugor kanë patur fokus kryesor minimizimin dhe parandalimin e numrit të aksidenteve rrugore. Në një gjerësi të rrjetit rrugor në shfrytëzim prej 3,606 km dhe në një densitet të llogaritur në vitin 2021 prej 12,54, për rritjen e sigurisë së këmbësorëve dhe sigurisë rrugore, studimi dhe evidentimi i shkeljeve të konstatuara apo arsyt kryesore të pezullimit të lejeve të qarkullimit për drejtuesit e automjeteve është një indikator i rëndësishëm në politikëbërjen e strategjive kombëtare mbi sigurinë në transportin rrugor.

Qëllimi i këtij punimi është të masë ndikimin e masave administrative të ndërmarra në vite në numrin e aksidenteve të ndodhura në vend (të tilla si gjoba, pezullimi lejes drejtimit) si dhe të studiojë burimin e tyre. Nga studimi i të dhënave mbi numrin e aksidenteve rrugore në vite, vihet re se përqindja më e madhe e aksidenteve kanë burim drejtuesin e mjeteve rrugore.

Në këtë artikull do të parashtrohen vlerësimet e të dhënave të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe të analizuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT) për të dhënat e viteve 2018-2021.

Nga të dhënat e analizuara për 4 vite, rezulton se numri i masave administrative ka ndikuar në mënyrë të zhdrejtë numrin e aksidenteve rrugore duke sjellë reduktimin e numrit të tyre si pasojë e rritjes së masave të ndërmarra, nga të cilat kryesojnë masat e marra për përdorimin e alkolit apo lëndëve narkotike, mos respektim i normave të shpejtësisë, mos respektim i sinjalizimeve rrugore apo parakalime të gabuara.

Fjalë kyçe:

Aksidente rrugore, sjellja e drejtuesit të mjetit, sjellja e këmbësorit, masë administrative.

1. Hyrje

Aksidentet automobilistike dhe pasojat që i shoqërojnë ato (traumat sociale, humbjet e mëdha ekonomike dhe jo vetëm) po perceptohen si rrezik e kërcënim permanent jo vetëm për këmbësorët e drejtuesit e mjeteve të transportit, por dhe për sigurinë publike e më gjerë. Për sa më sipër, siguria rrugore duhet kuptuar e vlerësuar si një e mirë publike dhe personale, pjesë e rëndësishme e sigurisë publike e kombëtare, e pranuar dhe e zbatuar si e drejtë themelore e njeriut. Procesi i sigurisë rrugore është një ndërveprim i vazhdueshëm midis disa faktorëve ku ndër më kryesorët janë sjellja e përdoruesve të rrugëve, siguria dhe kushtet e infrastrukturës rrugore si dhe karakteristikat e automjeteve. Ajo është një ndërthurje mes sigurisë parandaluese (parandalimin e aksidenteve) me sigurinë reaktive (rikuperimin e një situate emergjente) (Shala, 2020).

Nga të dhënat e marra në shqyrtim në analizë lidhur me gjobat dhe me lejet e drejtimit të pezulluara, janë konsideruar vetëm rastet ku shkelja mund të jetë burim aksidenti. Konceptet dhe përkufizimet e përdorura në këtë studim janë përcaktuar si më poshtë vijon:

- Aksidente rrugore përfshijnë çdo aksident rrugor të ndodhur nga të paktën një mjet rrugor i cili rezulton me të paktën një person të plagosur apo të vdekur.
- Aksidentet me pasoja përfshijnë të paktën një automjet rrugor në lëvizje në një rrugë publike ose private në të cilën publiku ka të drejtë hyrjeje, duke rezultuar me të paktën një person të plagosur ose të vrarë.
- Aksidentet nga sjellja e drejtuesit të mjetit janë aksidentet që ndodhin kur drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si: frenim i papritur, mosrespektimi i shenjave (sinjalistikës) së trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë, etj.
- Aksidentet nga sjellja e këmbësorëve ndodhin kur këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si: kalim rruge pa kujdes, etj. Masa administrative (Gjobë) është detyrimi që duhet ta shlyesh si dënim për një dëmtim, për shkeljen e një rregulli të përcaktuar me ligj për transportin rrugor.

Rregullat e qarkullimit rrugor kanë për qëllim të rregullojnë ndërveprimet ndërmjet përdoruesve të rrugës të cilët mund të jenë këmbësorë apo drejtues automjete (motomjete/ biçikleta).

- *Parandalimi i veprave penale dhe krimeve të tjera, udhëhequr nga filozofia e “policimit në komunitet”, përmes ndërveprimit të vazhdueshëm me komunitetin dhe organet e qeverisjes vendore (VKM, 2020)*

Ata synojnë një qarkullim të sigurt dhe të shpejtë të trafikut rrugor. Gabimet e paqëllimta dhe shkeljet e pavetëdijshme nga përdoruesit e rrugës mund të parandalohen kryesisht me anë të planeve, politikave apo masave të ndërmarra ndër vite, si dhe zbatimi i tyre.

Megjithatë, edhe në një plan masash për sigurinë rrugore apo sigurisë në komunitet të organizuar në mënyrë perfekte, disa grupe përdoruesish të rrugës mund të jenë ende të prirur për të shkelur rregullat e qarkullimit rrugor. Prandaj, zbatimi dhe ndëshkimi i shkelësve është një hap i fundit, por i domosdoshëm që synon parandalimin e përdoruesve të rrugës nga shkelja e qëllimshme e rregullave që mund të çojë deri në aksidente me pasoja.

2. Politikat e ndjekura në vend dhe Kuadri Ligjor lidhur me sigurinë rrugore

Sfidë mbetet parandalimi i aksidenteve rrugore me synim zbatimin e masave specifike me objektiv grupet, aktivitetet, sjelljet apo zonat me rrezikshmëri të lartë për aksidente, duke përsosur planifikimin dhe organizimin e shërbimeve në funksion të sigurisë në rrugë, efektshmërinë në shërbime, rritjen e fuqisë shtrënguese të ligjit ndaj shkelësve etj.

Një punë e veçantë është bërë në kuadër të rritjes së parametrave të sigurisë rrugore, duke zbatuar masa konkrete për parandalimin e aksidenteve me shtimin e masave administrative të vendosura si dhe pezullimin e lejeve të drejtimit për drejtues mjeteve shkelës të legjislacionit dhe të kriterëve të sigurisë rrugore.

Për periudhën e marrë në shqyrtim vitet 2018-2021, baza ligjore dhe politikat e ndjekura lidhur me sigurinë rrugore dhe nga aksidentet kanë qënë përkatësisht:

- Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr.8378, datë 22.7.1998, i ndryshuar;
- Strategjia Kombëtare për Sigurinë Rrugore 2011-2020;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1139, datë 24.12.2020 për miratimin e Strategjisë ndërsektoriale të sigurisë në komunitet 2021-2026;
- Urdhri i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 193, datë 20.3.2020 “Për Mbylljen apo Kufizimin e Lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”;
- Udhëzim i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës për “Sigurinë Rrugore dhe për drejtuesit e mjeteve” Nr.9 datë 14.04.2022.


Së fundmi, ndryshimet në Kodin Rrugor parashikojnë të ashpërsojnë masat ndaj drejtuesve të mjeteve që shkelin rregullat e qarkullimit, duke rritur kështu dhe vlerën e gjobave, sipas udhëzimit për “Sigurinë Rrugore dhe për drejtuesit e mjeteve” me Udhëzimin e ri të MIE, Nr. 9, dt. 14.4.2022. (MIE, 2022). Ndryshimi kryesor i shprehur sipas këtij udhëzimi është ripërsëritja e kursit drejtimit të mjetit dhe testeve të përkatese për ata drejtues mjeteve që, si pasojë e shkeljeve të vazhdueshme apo të rënda, humbin të gjitha pikët e Leje Drejtimit.

Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor lidhur me nismat e ndërmarra për sigurinë rrugore, nga viti 2018 janë miratuar 9 akte ligjore dhe nënligjore/VKM, më shumë në vitin 2021. (DPSHTRR, Nisma për Sigurinë Rrugore, 2021). Gjithashtu për 12 mujorin e vitit 2021, mundësia për çdo drejtues/mjet në qarkullim që të shkaktonte aksident ishte 0,16% pra 33% më pak se në 12 mujorin e vitit 2018. (DPSHTRR, Analizë mbi Sigurinë Rrugore, 2021).

3. Situata e treguesve të sigurisë rrugore

Bazuar në të dhënat zyrtare të INSTAT, ecuria e aksidenteve në vitet e marra në shqyrtim duke u krahasuar me vitet paraardhëse, kanë shënuar rënie, ku rënia më e madhe vihet re në vitin 2020 me 17,6% si dhe ulje të numrit të aksidentuarve prej 21,8 % krahasuar me vitin 2019. Kjo tendencë në rënie shihet dhe përgjatë viteve të tjera përveç vitit 2020 ku si pasojë e pandemisë Covid-19, tipologjia ka qënë e ndryshme dhe për shkak të kufizimit të qarkullimit për kohë të caktuara për këtë arsye përllogaritja për vitin 2021 është kryer krahasuar me vitin 2019. (Urdhër i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 193, datë 20.3.2020 “Për Mbylljen apo Kufizimin e Lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”).

Paraqitja grafike e ndryshimit vjetor në përqindje të numrit të aksidenteve rrugore dhe personave të aksidentuar, 2018-2021 paraqitet si vijon:




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Llogaritje INSTAT

*Për vitin 2021 vit krahasues është marrë 2019.

Burimi kryesor i këtyre aksidenteve, ndër vite, është sjellja e drejtuesve të mjeteve, ku në vitin 2021, 85% e aksidenteve kanë ardhur si pasojë e sjelljes së drejtuesve dhe 15% të rasteve kanë ardhur si pasojë e sjelljes së këmbësorëve. Ky raport është thujse konstant dhe për vitet e tjera të marra në shqyrtim në këtë artikull.


Paraqitja grafike e numrit të aksidenteve rrugore, aksidente si pasojë e sjelljes së këmbësorëve dhe drejtuesit të mjetit paraqitet si vijon:



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Llogaritje INSTAT

Nga analiza e aksidenteve të ndodhura sipas moshës së drejtuesit të mjetit vihet re se grupmosha 25-34 vjeç zë peshën më të madhe të aksidenteve rrugore.

Nga grafiku më poshtë vihet re se grupmosha e drejtuesve të mjeteve që ka sjellë më tepër aksidente është grupmosha 25-34 vjeç.



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Llogaritje INSTAT

Masat administrative të ndërmarra për periudhën 2018-2021

Bazuar në bazën e të dhënave zyrtare të INSTAT, me burim Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor është konstatuar se numri i masave administrative të marra për 1.000 autovetura (shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor që mund të jenë burim aksidentesh) ka ardhur në ulje vit pas viti nga 773 në vitin 2018, 613 në vitin 2019, 511 në vitin 2020 dhe 504 në vitin 2021, kjo dhe si pasojë e fushatave ndërgjegjëse të ndërmarra për parandalimin si hapin e parë dhe më të rëndësishëm të uljes së numrit të aksidenteve apo shkeljeve në tërësi lidhur me sigurinë rrugore të këmbësorëve apo drejtuesve të automjeteve. Nga analiza rezulton se, krahasimisht me vitin 2018 kemi një rënie prej 15,8% të masave administrative të vendosura në vitin 2021, ndërkohë, po në krahasim me vitin 2018 kemi 40,9% me pak Leje drejtimi të pezulluara për vitin 2021.

Po ashtu një numër i lartë masash administrative “Pezullim leje drejtimi” të drejtuesve të automjeteve tregon se duhet rritur ndërgjegjësimi për rritjen e sigurisë rrugore nga drejtuesit e mjeteve rrugore dhe këmbësorëve.


Viti	Masa administrative	Leje drejtimi pezulluar	Masa Administrative për 1.000 autovetura	Pezullim leje drejtimi për 1.000 autovetura
2018	355.445	23.015	↓ 773	↓ 50
2019	306.020	12.899	↓ 613	↓ 26
2020	278.127	14.053	↓ 511	↓ 26
2021	299.115	13.579	↓ 504	↓ 23

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, Llogaritje INSTAT

Siç është cituar dhe më sipër, lidhur me vitin 2020, masat administrative të ndërmarra në këtë vit kanë qënë më të ulta në periudhën 2018-2021, kushtëzuar kjo dhe nga kufizimi i qarkullimit rrugor si pasojë e pandemisë së COVID-19. Në vitin 2021, vihet re një rritje e numrit të masave administrative krahasuar me vitin 2020, në masën 7,5 %, ndërsa raporti i “Masave administrative për 1.000” banorë paraqitet me ulje në 1,4%.

Në uljen e këtij treguesi ka ndikuar rritja me 9% e numrit të autoveturave në qarkullim në vendin tonë krahasuar me 2020.

Paraqitja grafike e masave administrative dhe pezullimit të lejeve të drejtimit për 1.000 autovetura lidhur me numrin e viktimave nga aksidentet për 1 milion banorë:



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, Llogaritje Instituti i Statistikave (INSTAT)

Gjetjet nga analiza e të dhënave midis aksidenteve dhe masave administrative për Shqipërinë

Të dhënat e përdorura në këtë studim janë bazuar në dy burime të dhënash të cilat janë të disponueshme nga Instituti i Statistikave, të dhëna të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Të dhënat mbi Aksidentet rrugore ofrojnë informacion për numrin e aksidenteve rrugore dhe të aksidentuarve në vend dhe paraqesin dinamikën e aksidenteve rrugore si dhe masat e ndërmarra për rritjen e sigurisë rrugore.

Seria kohore e të dhënave të marra në shqyrtim përfshin vitet 2018-2021 dhe variablat e analizuara janë:

- Numri i aksidenteve rrugore;
- Numri i personave të aksidentuar (të vrarë dhe të plagosur);
- Numri i masave administrative të ndërmarra;
- Numri i lejeve të pezulluara;
- Numri i autoveturave që qarkullojnë në vend.

Për të studiuar lidhjen që kanë këto tregues në numrin e aksidenteve rrugore, pra sigurisë rrugore, është përdorur Metoda e të dhënave OLS (Metoda e katrorëve më të vegjël). Si një analizë parashikuese, ky regresion është përdorur për të shpjeguar marrëdhënien midis variablit të varur të vazhdueshëm dhe variablave të pavarur. Koeficienti i përcaktueshmërisë, R², është një mjet statistikor që përfaqëson raportin e variancës për një variabël të varur që shpjegohet nga një ose më shumë variabla të pavarur të konsideruara në modelin e regresionit. Më poshtë paraqitet dhe formula për llogaritjen e këtij koeficienti:

$$R^2 = \frac{\text{Varianca e shpjeguar nga Modeli}}{\text{Varianca Gjithsej}}$$

R² mat fuqinë e marrëdhënies midis modelit të vlerësuar dhe variablave të varur në një shkallë përcaktueshmërie 0 – 100%. Rëndësia statistikore e metodës së përdorur OLS tregon nëse kemi arsye të besojmë se një marrëdhënie/ efekt ekziston ndërmjet variablave.

Në rastin tonë, variabël i varur është konsideruar numri i aksidenteve rrugore dhe dy variabla të pavarur, përkatësisht numri i masave administrative të ndërmarra dhe numri i lejeve të pezulluara për serinë kohore referuese vitet 2018-2021.

Nga analiza rezulton se koeficienti i përcaktueshmërisë, R², i cili mat fuqinë e marrëdhënies midis modelit tonë dhe variablave të varur në një shkallë përcaktueshmërie 0 – 100%, rezulton në 98% (R²=0.98). Ky rezultat tregon se lidhja lineare apo përshtatshmëria midis variablave të marra në shqyrtim është e fortë.

Megjithatë, nuk është gjithmonë rasti që një koeficient R² i lartë në modelin e regresionit, përcakton lidhjen më të saktë dhe cilësore të përshtatjes së variablave ndërmjet tyre. Cilësia e matjes statistikore varet nga shumë faktorë, siç janë natyra e variablave të përdorur në model, njësitë matëse të variablave dhe transformimi i të dhënave të aplikuara, kohëzgjatja e serisë të analizuar, etj.

Më poshtë paraqiten statistika përmbledhëse të regresionit të analizuar.

Regression Statistics	
Multiple R	0,993869074
R Square	0,987775737
Adjusted R Square	0,963327211
Standard Error	39,26027966
Observations	4

ANOVA					
	df	SS	MS	F	Significance F
Regression	2	124549,6304	62274,82	40,40226	0,11056339
Residual	1	1541,369559	1541,37		
Total	3	126091			

Nga vlerësimi i lidhjes midis numrit të aksidenteve rrugore dhe dy variablave të varur, përkatësisht numri i masave administrative të ndërmarra dhe numri i lejeve të pezulluara vihet re se lidhja midis numrit të lejeve të pezulluara dhe numrit të aksidenteve është negative. Pra, për 100 leje drejtimi të pezulluara ndodhin 1.7 aksidente më pak, pra rreth 2 aksidente më pak.

Analiza krahasimore me vendet e rajonit për vitin 2021


Nga analiza e të dhënave të vendit tonë krahasuar me vendet e rajonit, Shqipëria renditet e treta nga shtatë vendet e marra në analizë përse i përket numrit të personave me pasojë vdekjen nga aksidentet, përkatësisht me 197 persona për vitin 2021, ndërkohë Greqia renditet e fundit me 616 persona të vdekur nga aksidentet për vitin 2021.

Më poshtë paraqitet tabela me numrin e të vdekurve nga aksidentet/ të vdekur për 1 mln banorë si pasojë e aksidenteve rrugore në vitin 2021 në rajon sipas shteteve për vitin 2021

Shteti	Të vdekur nga aksidentet 2021	Të vdekur/ 1mln banorë
Bosnjë Hercegovina /Bosnia and Herzegovina	446	129,20
Mali i Zi / Montenegro	55	89,04
Kroacia / Croatia	292	71,91
Serbi/ Serbia	491	71,45
Shqipëria/ Albania	197	70,51
Maqedonia e Veriut / North Macedonia	116	63,15
Greqi/ Greece	616	62,19

Burimi: Faqet zyrtare të Institucioneve të statistikave, Llogaritje Instituti i Statistikave (INSTAT)

Paraqitja grafike e numrit të të vdekurve si pasojë e aksidenteve rrugore në vitin 2021 në rajon sipas shteteve.



Burimi: Faqet zyrtare të Institucioneve të statistikave, Llogaritje Instituti i Statistikave (INSTAT)

4. Përfundimet

Aplikimi i strategjive dhe masave administrative për rritjen e sigurisë rrugore është një sfidë komplekse dhe e vështirë e cila kërkon monitorim dhe informacion në mënyrë të vazhdueshme.

Angazhimi në kuadrin e politikave është shumë i rëndësishëm në sigurinë rrugore dhe duhet të përmbajë tre elemente të rëndësishëm që të funksionojë: *infrastruktura rrugore, mjetet rrugore* dhe përdoruesit e rrugës (këmbësorë apo drejtues mjetesh).

Strategjitë, planet e veprimtari si dhe kuadri ligjor ndërinstitucional ndër vite synon vetëdërgjegjësimin dhe parandalimin si hapin e parë dhe më të rëndësishëm të uljes së numrit të aksidenteve apo shkeljeve në tërësi lidhur me sigurinë rrugore të këmbësorëve apo drejtuesve të automjeteve.

Nga analiza e kryer në artikull, sipas Metodës OLS të regresionit linear rezultoi se qëndron lidhja e zhdrejtë mes numrit të aksidenteve dhe lejeve të pezulluara të drejtimit të drejtuesve të automjeteve, që nënkupton se rritja e variablës "Pezullimi i lejeve të drejtimit të drejtuesve të mjeteve për shkeljet që shpien në aksidente" ndikon në uljen e numrit të aksidenteve rrugore.

Rëndësia statistikore e kësaj metode të përdorur tregon se kemi arsye të besojmë se ekziston një marrëdhënie ndërmjet variablave. Nuk do të thotë domosdoshmërisht se efekti është mjaftueshëm i rëndësishëm për të qenë përcaktues.

Ky studim ka disa kufizime, kryesisht për shkak të natyrës së të dhënave të përdorura. Janë marrë në konsideratë vetëm dy variabla shpjegues të numrit të aksidenteve rrugore, por nuk janë marrë në shqyrtim faktorë të tjerë si infrastruktura rrugore, gjendja e mjetit, etj. Kufizim tjetër është seria e shkurtër e të dhënave të analizuara (2018-2021), në të cilat viti 2020 rezultoi një vit me kufizime lidhur me qarkullimin rrugor të cilët kanë afektuar të dhënat mbi variablat e marra në shqyrtim.

Referenca

- [1] Analizë mbi Sigurinë Rrugore, Tiranë; DPSHTRR 2021;
- [2] Kodi Rrugor i RSH, Ligj Nr.8378, datë 22.7.1998, I ndryshuar;
- [3] Nisma për Sigurinë Rrugore, Tiranë; DPSHTRR 2021;
- [4] Strategjia Kombëtare për Sigurinë Rrugore 2011-2020;
- [5] Strategjisë ndërsektorale të sigurisë në komunitet 2021-2026 miratuar me VKM Nr. 1139, datë 24.12.2020;
- [6] Urdhërit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 193, datë 20.3.2020 “Për Mbylljen apo Kufizimin e Lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”;
- [7] Udhëzim Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës për “Sigurinë Rrugore dhe për drejtuesit e mjeteve” Nr.9 datë 14.04.2022;
- [8] Web: [INSTAT](#); [State Statistical Office, Rep.North Macedonia](#); [Statistical Office of Montenegro](#); [Statistical Office of the Republic of Serbia](#) ; [Croatian Bureau of Statistics](#); [Agency for Statistics of Bosnia and Herzegovina](#); [Hellenic Statistical Authority \(Greece\)](#);

KEQPËRDORIMI DHE KEQINTERPRETIMI I STATISTIKAVE ZYRTARE

Autori:

MARINELA LAMÇE,

Instituti i Statistikave

mlamce@instat.gov.al

Abstrakt

Shpeshherë shohim keqinterpretim dhe keqpërdorim të statistikave zyrtare, kryesisht në media, por ndonjëherë edhe në punime studentore, apo publikime artikujsh informues ose shkencorë. Instituti i Statistikave ndjek një rregull të caktuar për të korrigjuar keqinterpretimet dhe keqpërdorimet të statistikave zyrtare në media, duke u bazuar në Politikën e shpërndarjes së informacionit. Në këtë artikull informues, do të trajtojmë hapat që Instituti i Statistikave ndjek kur evidenton një keqinterpretim apo keqpërdorim, si edhe zbatimin e parimeve të shpërndarjes së statistikave zyrtare.

Fjalë kyçe:

Keqinterpretim; Keqpërdorim; Trajtimi i gabimit;

1. HYRJE

Roli i Institutit të Statistikave (INSTAT) është të prodhojë statistika zyrtare, të mbledhë, përpunojë, analizojë, publikojë dhe arkivojë të dhëna. Bazuar në ligjin “Për Statistikat Zyrtare”, neni 14, Pika 2d, thuhet se “INSTAT është përgjegjës për të dhënë ndihmën profesionale në interpretimin e drejtë të statistikave zyrtare dhe për të nxitur rolin dhe kuptimin e statistikave në Shqipëri”. Në këtë kuadër, INSTAT ka mirëpritur kërkesat e përdoruesve nëpërmjet adresës zyrtare info@instat.gov.al të cilat lidhen me metodologjinë e përdorur në publikimet e saj apo sqarime të tjera të cilat kanë të bëjnë me përdorimin e të dhënave statistikore. Përpos kërkesave nëpërmjet adresës zyrtare, INSTAT realizon edhe takime me palë të interesuara për të shpjeguar se si t’i interpretojnë statistikat.

Informacioni statistikor i publikuar shoqërohet gjithmonë me një përshkrim të qartë mbi metodologjinë e proceseve statistikore, përfshirë përdorimin e të dhënave administrative.

Për të qenë sa më pranë përdoruesve dhe për të shmangur keqpërdorimet dhe keqinterpretimet, INSTAT zbaton parimet e përgjithshme të shpërndarjes së statistikave zyrtare të cilat janë:

- Akses i Barabartë –INSTAT njofton paraprakisht datat e shpërndarjes së Statistikave zyrtare në Kalendarin e tij Vjetor dhe të gjithë kategoritë e përdoruesve, përfshirë Eurostat, autoritetet shtetërore dhe media, kanë akses të këtij kalendarit në të njëjtën kohë;
- Paanshmëria, objektiviteti dhe transparenca - Shpërndarja e informacionit statistikor zbatohet nga INSTAT. Neni 4 i Ligjit “Për Statistikat Zyrtare” shprehimisht përcakton “paanshmërinë” si një parim udhëzues për organizimin dhe zbatimin e Programit Statistikor. Në statistikat zyrtare nuk përfshihet asnjë koment politik apo komente të autoriteteve qeveritare;
- Publikimi i njëkohshëm - Në momentin që një njoftim për shtyp publikohet sipas datës së përcaktuar në kalendarin e publikimeve, njëkohësisht publikohen edhe të dhënat statistikore që përditësohen në databazën statistikore;
- Të dhënat identike në të gjitha burimet - Për të garantuar të dhëna identike në të gjitha burimet në dispozicion, të gjitha njoftimet për shtyp, botimet, etj., që INSTAT publikon janë të disponueshme dhe të përdorshme nga databaza statistikore;
- Shpërndarje me metadata - Statistikat zyrtare gjithmonë duhen shpërndarë me metadata dhe me shpjegime shumë të qarta për të shmangur keqinterpretimet dhe keqpërdorimet;
- Konfidencialiteti dhe gabimi njerëzor - INSTAT ka rritur mbrojtjen e konfidencialitetit vitet e fundit, dhe Databaza e re e të Dhënave ka ofruar një përmirësim të shtuar teknologjik;
- Politikat e çmimeve dhe ato pa pagesë - Sipas Ligjit “Për Statistikat Zyrtare”, neni 29, Statistikat Zyrtare janë falas për publikun dhe çdokush mund t’i përdorë ato përmes faqes së internetit; Design & Layout plotëson udhëzimet e Eurostat – Botimet dhe publikimet janë në përputhje me Udhëzuesin e Stilit Grafik të Eurostat.

Për të rritur vizibilitetin e tij, INSTAT ka rritur gamën e produkteve statistikore dhe format e shpërndarjes së statistikave zyrtare për t’i ardhur në ndihmë dhe për të qenë sa më afër përdoruesve. INSTAT ofron shërbimin statistikor nëpërmjet formave të mëposhtme:

- Publikime të botuara sipas një plan kalendarit të paracaktuar;
- Formate të printuara të publikimeve;
- Botime në Website zyrtar të INSTAT;
- Databaza statistikore;
- Aplikacioni Web-Gis.

2. PROCESET E SHPËRNDARJES SË STATISTIKAVE ZYRTARE

INSTAT shfaq datat e publikimeve të statistikave për vitin pasardhës në Kalendarin Vjetor të Publikimit në 20 Dhjetor të çdo viti. Ky kalendar është në dispozicion për publikun e gjerë në faqen zyrtare të INSTAT në www.instat.gov.al. Çdo publikim i statistikave zyrtare vihet në dispozicion të publikut në faqen e internetit në orën 11:00 sipas datës së përcaktuar në kalendar. Të dhënat që publikohen vetëm në internet (për shembull tabelat e paracaktuara) përditësohen automatikisht në orën 11:00 të paradites në datën e përcaktuar në kalendar, duke përdorur të dhënat nga baza e të dhënave statistikore. Kopjet në letër të botimeve janë në dispozicion të përdoruesve nga ora 11:00 e paradites.

2.1 Trajtimi i gabimit

Për të siguruar një kornizë të përbashkët për menaxhimin e gabimeve në të gjithë fushat e prodhimit statistikor, INSTAT ka hartuar politikën e trajtimit të gabimeve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së proceseve statistikore, produkteve dhe shërbimeve. Për të shmangur keqpërdorimet dhe keqinterpretimet, INSTAT informon përdoruesit për korrigjimin e gabimit.


Gabimet e identifikuar nga INSTAT ndahen në llojet e mëposhtme:

- 1. Gabime me një ndikim të parëndësishëm:** të dhëna të pasakta që nuk ndikojnë dhe nuk ndryshojnë të dhënat statistikore. Ato përfshijnë, për shembull, gabime gramatikore, ose drejtshkrimore, linqe të paplota apo të papërditësuara, të cilat nuk ndikojnë në interpretimin të dhënave statistikore;
- 2. Gabime me ndikim të vogël:** tabela të gabuara, tekst ose të dhëna nga grafiku rëndësia e të cilit është aq e vogël sa përmbajtja e informacionit mbetet e pandryshuar
- 3. Gabime me një shkallë të lartë ndikimi/ kritike:** tabela të gabuara, tekst ose të dhëna të grafikut të cilat kanë pasojë të konsiderueshme ekonomike ose përbëjnë një shkelje të mbrojtjes dhe konfidencialitetit të të dhënave.

Në raste të tilla, INSTAT bën korrigjimet në varësi të llojit të gabimit. Kur gabimi i evidentuar është i madh, INSTAT publikon variantin e korrigjuar me shënimin shoqërues “i korrigjuar” por duke mos hequr variantin e parë me gabime në mënyrë që përdoruesit të shohin se ku është bërë korrigjimi. Në figurën 1 shihet ilustrimi i një korrigjimi.

Figura 1: Korrigjim i një publikimi

Aksidentet Rrugore, Shtet 2020	18-03-2020	
Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit, Shtet 2020	18-03-2020	
Tregtia e Jashtme, Shtet 2020	17-03-2020	
Statistika mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, 2018	11-03-2020	
Indeksi i Çmimeve të Konsumit, Shtet 2020	08-03-2020	
Statistika e Transportit, Janar 2020	27-02-2020	
Livëzimi i Shërbimeve, Janar 2020	24-02-2020	
Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit, Janar 2020	21-02-2020	
Tregtia e Jashtme, Janar 2020 (i korrigjuar)	18-02-2020	
Aksidentet Rrugore, Janar 2020	18-02-2020	
Tregtia e Jashtme, Janar 2020	17-02-2020	
Hqetimi për Media - Rezultate të Analizës Strukturore të Ndërmarrjeve Ekonomike, 2019	14-02-2020	
Rezultate të Analizës Strukturore të Ndërmarrjeve Ekonomike, 2018	14-02-2020	
Indeksi i Çmimeve të Konsumit, Janar 2020	07-02-2020	
Partidat e Fugës Blerëse, 2019		
Huata Cens, Nr 1		
Huata Cens, Nr 2		
Huata Cens, Nr 3		
Huata Cens, Nr 4		
Huata Cens, Nr 5		
Huata Cens, Nr 6		
2019		
2018		



2.2 Keqinterpretimi dhe keqpërdorimi i statistikave zyrtare

Pavarësisht masave të marra për përmirësimin e produktit statistikor, shtimin e produkteve dhe formës së shpërndarjes së produktit statistikor, keqinterpretimet dhe keqpërdorimi i statistikave zyrtare janë të pranishëm në media apo botime.

Interpretimi i gabuar i statistikave zyrtare do të thotë që për shkak të mungesës së njohurive jo të mira të fushës, treguesit e saktë statistikorë janë vendosur në një kontekst në të cilin do të ishte më mirë të përdoreshin tregues të tjerë statistikorë ose të shtoheshin diçka tjetër në parametrat e përdorur. Keqpërdorimi i statistikave zyrtare nënkupton nxjerrjen e konkluzioneve arbitrare në bazë të të dhënave të sakta ose të pasakta.

Sipas politikës së shpërndarjes së informacionit statistikor, nëse statistikave zyrtare janë keqinterpretuar ose keqpërdorur, Drejtoria e Komunikimit dhe Publikimeve (ose përfaqësuesi i sektorit përkatës) duhet të kontaktojë përdoruesin në fjalë, t'i tërheqë vëmendje për keqinterpretimin ose keqpërdorimin e të dhënave dhe t'i sigurojë informacionin e saktë. Në rast të keqinterpretimit ose keqpërdorimit në media, kjo drejtori duhet të koordinojë me redaktorin e medias nëse një njoftim i gabimit, një artikull shpjegues i shkruar nga INSTAT ose një intervistë me një përfaqësues të INSTAT, duhet të publikohet nga kanali mediatik për të shpjeguar keqinterpretimin apo keqpërdorimin. Nëse është e nevojshme, INSTAT mund të publikojë shpjegimin në formën e një njoftimi për shtyp.

2.3 Si vepron INSTAT?

INSTAT ka krijuar një seksion të dedikuar të emërtuar “Reagime” ku publikon të gjitha reagimet për median dhe institucionet e tjera në rastet kur të dhënat keqpërdoren apo keqinterpretohen. Në këtë mënyrë, përdoruesit informohen për lajme të cilat kanë të dhëna të pasakta ose janë keqpërdorur. Në fund të çdo sqarimi, INSTAT fton çdo media apo institucion që ka keqpërdorur apo keqinterpretuar statistikën zyrtare të publikojë reagimin e tij duke shkruar **“Ju lutem këtë sqarim ta publikoni në median tuaj si qëndrim zyrtar të INSTAT ndaj këtyre artikujve.”** Figura 2 paraqet mënyrën sesi INSTAT publikon reagimet në faqen zyrtare.

Figura 2: Mënyra e paraqitjes së reagimit në faqen zyrtare

REAGIME

Në këtë seksion do të gjeni të gjitha reagimet e INSTAT për median dhe institucionet e tjera, kur të dhënat keqpërdoren ose keqinterpretohen.

Reagime		
 REAGIM	 REAGIM	 REAGIM
Sqarim për media mbi artikullin e gazetës Albanian Daily News 13-10-2022	Njoftim mbi shtyrjen e Censit të Popullsisë dhe Banesave 25-08-2022	Sqarim për media mbi databazën statistikore 30-12-2021

2.4 Kontakti me median

INSTAT kontakton me mediat të cilat kanë pasyruar lajmin, duke i kërkuar të sqarojnë opinionin publik mbi keqinterpretimin e shifrave. Në linkun në vijim shihet sesi reagimi i INSTAT është reflektuar në media <https://www.youtube.com/watch?v=xA3TcDdndec>. Një mënyrë tjetër sesi INSTAT reagon ndaj lajmeve të publikuara me statistika të keqpërdorura apo keqinterpretuara është nëpërmjet komunikimit me e-mail.

3. KONKLUZIONET

INSTAT synon që nëpërmjet rritjes së njohurive dhe informimit të statistikave zyrtare, të minimizojë dhe, mundësisht, të shmangë keqpërdorimet dhe keqinterpretimet e statistikave zyrtare. INSTAT ka lançuar në vitin 2019 në faqen zyrtare të internetit seksionin “Statistika në shkollë”, qëllimi i të cilit është njohja e të rinjve me termat kryesorë të statistikave. Kjo i vjen në ndihmë të gjithë nxënësve, studentëve si dhe atyre që kanë interes për statistikë, për të qenë në gjendje të kuptojnë më mirë statistikën dhe disa nga konceptet themelore të saj.

Statistikat zyrtare ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve të saj mbi proceset e zhvillimit, transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit dhe janë burim krahasimi me vendet e tjera. Duke qenë sa më pranë përdoruesve dhe duke ndihmuar në interpretimin e të dhënave, INSTAT synon në një interpretim të drejtë të statistikave zyrtare për të nxitur rolin dhe kuptimin e statistikave në Shqipëri.

Referenca

[1] www.instat.gov.al

[2] DISSEMINATION POLICY & GUIDELINES <http://www.instat.gov.al/media/4193/dissemination-policy-guideline.pdf>

[3] Reagime INSTAT <http://www.instat.gov.al/al/publikime/reagime/>

[4] Top channel <https://www.youtube.com/watch?v=AyeOYluHMoc>

[5] Kalendari i publikimeve, INSTAT: <http://www.instat.gov.al/al/publikime/njoftime-p%C3%ABr-media/>

TRAJTIMI I MOS PËRGJIGJES NË ANKETËN E TË ARDHURAVE DHE NIVELIT TË JETESËS NË SHQIPËRI

Autorët:

BLERINA MEMAJ (bmemaj@instat.gov.al)

Abstrakt

Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës mbledh çdo vit të dhëna mikro, në kohë dhe të krahasueshme me vendet e tjera të Rajonit dhe më gjërë, për të përcaktuar nivelin e varfërisë bazuar mbi të ardhurat dhe përjashtimin social. Ky studim përfshin dy kategori të dhënash, të dhëna vjetore dhe të dhëna panel në familje dhe në nivel individual. Trajtimi i mos përgjigjes është një problem statistikor i hasur në faza të ndryshme të anketimit pranë familjeve dhe individëve, i cili ndikon në cilësinë e studimit dhe analizës statistikore.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të paraqesë se si e trajtojmë nivelin e mos përgjigjes bazuar në Anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ) që mbulon editimin dhe imputimin e të dhënave. Ekzaminimi i procedurave të ndjekura mund të vlerësojë cilësinë e këtij studimi dhe mund të përmirësojë analizën statistikore. Këto procese prodhojnë të dhëna me cilësi të lartë në mënyrë që të ruajnë besimin e publikut në statistikat zyrtare.

Fjalë kyçe:

AANJ, të dhëna vjetore, të dhëna panel, imputime në mospërgjigje, editim

1. HYRJE

Në ditët e sotme, përdoruesit e informacionit statistikor kërkojnë të dhëna me cilësi të lartë në aspektet sociale, demografike, industriale, ekonomike, financiare, politike dhe kulturore të shoqërisë me një nivel të madh detajesh. Institutet Statistike Kombëtare përmbushin një rol qendror në sigurimin e një informacioni statistikor me cilësi të lartë.

Anketa për të Ardhurat dhe Nivelin e Jetesës (AANJ) është burim i statistikave krahasuese për të ardhurat dhe nivelin e jetesës në shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian dhe jo vetëm.

Projekti i Statistikave Evropiane për të Ardhurat dhe Nivelin e Jetesës u lançua për herë të parë në Shqipëri në 2017 dhe nisur nga ky vit po kryhet në baza vjetore. Ky studim është burimi kryesor i statistikave kombëtare për shpërndarjen e të ardhurave, matjen e varfërisë dhe përjashtimin social.

Në këtë studim të dhënat janë mbledhur në:

I. Nivel Familje;

- Të ardhurat - Komponentët e të ardhurave në nivelin e familjes;
- Strehimi - Lloji i banimit, statusi i banimit dhe kushtet e strehimit, kostot e strehimit;
- Përjashtimi Social - Treguesit e privimit jomonetar të familjeve, përfshirë problemet në plotësimin e nevojave bazë, masën e borxhit dhe pamundësia e plotësimit të nevojave themelore.

II. Nivel Individual (ku përfshihen të gjithë të rriturit e moshës 16+ në secilën familje);

- Te dhëna Personale mbi Statusin martesor, arsimin;
- Gjëndjen shëndetësore;
- Informacionin lidhur me Punën - Informacioni bazë i punës mbi aktivitetin e statusit aktual dhe statusit të kaluar mbi punën, përfshirë informacionin mbi punën e fundit dhe punën e mëparëshme si dhe të ardhurat personale mujore dhe vjetore.

Këto tregues vlerësohen në dimensionet vjetore dhe panel.

Të dhënat vjetore (**Cross-sectional**) i përkasin një kohe të caktuar ose një periudhe të caktuar kohe me variabla mbi të ardhurat, varfërinë, përjashtimin social dhe kushtet e tjera të jetesës (European Commission, *Methodological Guidelines and description of EU-SILC target variables*, EU-SILC doc 65/01);

Të dhënat panel (**Longitudinal**) kanë të bëjnë me ndryshimet e nivelit individual me kalimin e kohës, të vëzhguara në mënyrë periodike gjatë një periudhe katër-vjeçare (European Commission, *Methodological Guidelines and description of EU-SILC target variables*, EU-SILC doc 65/01).

Mbledhja e të dhënave bazohet në udhëzime metodologjike të Eurostat i cili mundëson realizimin e një ankete në nivel familje të krahasueshme në nivel EU duke bërë të mundur zhvillimin e Anketës me standardet më të larta të cilësisë. Metoda e përdorur për AANJ përfshin intervista personale midis një shembulli përfaqësues të familjeve dhe personave që jetojnë në këto familje në kohën e mbledhjes së të dhënave. Në vitin 2018, 7,800 familje u kontaktuan për këtë anketë.

Metodologjia e kampionimit e përdorur për AANJ përfshin një panel përsëritës, i cili kërkon që tre të katërtat e familjeve që përgjigjen në një vit të veçantë të përcillen për studimin e vitit të ardhshëm dhe vetëm një e katërta e kampionit është e re duke u studiuar kështu për herë të parë. Në këtë mënyrë, për një periudhë 4 vjeçare studiohet një e katërta e familjeve të përzgjedhura e cila kontaktohet gjatë katër viteve radhazi. Në tabelën 1 është paraqitur paneli përsëritës duke nisur nga viti 2016 dhe duke përfunduar me vitin 2019 me të cilin plotësohet paneli katër vjeçar.

Tabela 1: Kampioni përsëritës sipas viteve e ndarë në 4 grupe përsëritëse për secilin vit.

Grupet përsëritëse të kampionit ndër vite							Viti
1	2	3	4				2016 (anketa pilot)
	2	3	4	1			2017
		3	4	1	2		2018
			4	1	2	3	2019

Kjo metodologji bën të mundur që INSTAT të analizojë më saktë ndryshimet në të ardhurat dhe situatën socio-ekonomike të familjeve për një periudhë relativisht të gjatë kohore (4 vjeçare). Metoda e mbledhjes së të dhënave në Shqipëri është përmes intervistave ballë për ballë përmes kompjuterit (CAPI), duke përdorur intervistat direkte ose përmes përfaqësuesve anëtar të familjes (proxy) kur kjo është e pashmangshme.

Mbledhjet e të dhënave në anketë janë një burim i mundshëm i gabimeve. Mos përgjigjet janë një nga problemet kryesore me të cilat duhet të përballen autoritetet statistikore kombëtare gjatë kryerjes së editimit dhe imputimit të të dhënave. Të dhënat pa përgjigje dhe të pavlefshme patjetër që ndikojnë në cilësinë e rezultateve të anketës. Imputimi zgjidh problemet e përgjigjeve të munguara, të pavlefshme ose jo, të plota të identifikuar gjatë editimit, si dhe çdo gabim editimi që mund të ketë ndodhur.

2. Trajtimi i mospërgjigjes së të dhënave statistikore

Kampioni i anketës mbulon të gjithë territorin e Shqipërisë. Kampioni përfaqëson të gjithë popullsinë, si dhe grupet më tipike të saj. Familjet kolektive si; shtëpitë e të moshuarve, shtëpitë për fëmijët me aftësi të kufizuara, konviktet e studentëve, hotelet, kazermat e ushtarëve, spitalet, senatoriumet, institucionet e burgimit, etj janë përjashtuar nga anketa.

Arsyet kryesore në AANJ për të mos pasur informacion nga familja janë se ata refuzojnë të bashkëpunojnë ose janë përkohësisht në mungesë, banesa nuk është gjetur, familjet mungojnë përkohësisht, familjet që nuk janë në gjendje të përgjigjen (arsye shëndetësore), banesa bosh etj.

Menaxhimi i mos-përgjigjeve kur shkalla e mos-përgjigjes është më e lartë bëhet e nevojshme dhe kjo vjen në dy faza: parandalimi dhe trajtimi.

- Gjatë fazës së parandalimit, të gjitha strategjitë dhe përpjekjet për të arritur një shkallë të lartë përgjigjeje dhe cilësinë e të dhënave vihen në veprim të tilla si trajnimi i duhur (keqkuptimi i pyetjes, sqarimet e detajuara me shembuj etj.), Ndjekjet e vazhdueshme përmes kontrolleve në terren dhe komunikimeve telefonike, rikujtimi nëpërmjet postës elektronike, etj.
- Proçesi i hedhjes së të dhënave, imputimit, editimit, trajtimi, duke përdorur programe CsPro, SAS dhe SPSS.

Editimi dhe imputimi i të dhënave panel përfshin marrjen në konsideratë të vlerave ndihmëse nga vala aktuale, valët e mëparshme (vendet që përdorin një panel përsëritës ose afatgjatë do të aplikojnë një metodë të përbashkët imputimi për komponentin vjetor dhe panel). Nëse të dhënat e një individi mungojnë në vitin aktual, për shembull paga, por ka të dhëna që ai / ajo është i punësuar, atëherë ne analizojmë karakteristikat e punësimit të këtij individi vitin e kaluar dhe nëse ato janë të ngjashme atëherë ne imputojmë. Gjithashtu, nëse pensionet për valën e re mungojnë, atëherë merret parasysh një mesatare e qarkut, bazuar në disa faktorë themelorë siç janë: vitet e punës, lloji i profesionit, mosha, etj. Këto të dhëna të grumbulluara gjithashtu mund të krahasohen sipas rrethit bazuar në të dhëna administrative vetëm për të parë se si vijnë në krahasim me imputimet që mund të kryhen. Ende nuk është e mundur të përdoren burimet e të dhënave administrative në anketën e AANJ në nivel mikro. Në një rast të veçantë të konvertimit të të ardhurave neto në bruto, vendi ynë të ardhurat neto i konverton duke zhvilluar një algoritëm përsëritës për transferimin e të dhënave nga neto në bruto. Ky model bazohet në aplikimin e legjislacionit tatimor në fuqi për vendin tonë.

Peshimi dhe imputimi janë dy metodat kryesore të përdorura për të korrigjuar ndikimet në anketë për shkak të mospërgjigjes dhe për të bërë përdorimin eficient të të dhënave. Peshimi përdoret në mënyrë klasike për të trajtuar problemin e mospërgjigjes në nivel njësie, ndërsa imputimi përdoret për të trajtuar problemet e mospërgjigjes në nivel variabli (S. Rassler 2004).

Mospërgjigja në nivel variabli lind kur disa të dhëna mblidhen për një njësi por vlerat e disa variabllave mungojnë, për shembull i anketuari refuzon të japë përgjigjen e një pyetjeje të ndjeshme ose nuk është në gjendje të sigurojë përgjigjen e një pyetjeje që kërkon informacion kompleks. Variabllave që ju mungojnë vlerat zëvendësohen duke përdorur metodat e imputimit. Qasja tradicionale për imputim në statistikat zyrtare është të prodhohet vetëm një vlerë e imputuar për secilin variabli që mungon. Analiza e imputimit bëhet duke përdorur një procedurë të integruar SPSS për të zëvendësuar vlerën që mungon duke përdorur vlerësime si: Mesatarja (mesatarja e vlerave përreth) dhe Trendi (prirja lineare në atë pikë).

2.1 Gabimi në mospërgjigje

Shumë njerëz nuk japin informacione të sakta sidomos për të ardhurat e tyre, statusin e punësimit, pagesat e taksave etj. Ekzistojnë një numër burimesh për gabime përgjigjeje siç janë instrumentet e anketës, sistemi i informacionit, stafi i terrenit dhe mënyra e mbledhjes. Gabimet e mos përgjigjes janë gabime për shkak të një përpjekje të pasuksesshme për të marrë informacionin e dëshiruar nga një njësi e pranueshme.

Janë konsideruar dy lloje kryesore të gabimeve të mospërgjigjes:

2.1.1 Mospërgjigje në nivel njësie

1) Mospërgjigja në nivel njësie i referohet mungesës së informacionit nga të gjitha njësitë (familjet dhe / ose personat) të zgjedhur në kampion (Gianni Betti, Vijay Verma, Giulio Ghellini 2006).

Treguesit që synojnë të matin mos-përgjigjen e njësisë në AANJ janë përkatësisht (Eurostat-Metodologjia e EU-SILC);

2) Norma e kontaktit të adresës: raporti i numrit të adresave të kontaktuar me sukses, me numrin e adresave të vlefshme të zgjedhura

3) Norma e përgjigjes së familjeve: raporti i numrit të intervistave të kryera nga familjet (dhe të pranuar në bazën e të dhënave), me numrin e familjeve të kualifikuara në adresat e kontaktuara

4) Norma e përgjigjes individuale: raporti i numrit të intervistave personale të përfunduara (dhe të pranuar në bazën e të dhënave), me numrin e individëve të kualifikuar në familjet e përfunduara.

Mos përgjigja është kumulative në tre fazat (kontakti i adresës, intervista e familjes dhe intervista personale).

Norma e përgjigjes llogaritet si:

Norma e përgjigjes = E përfunduar / (Njësia e kontaktuar - njësiti e papranueshme)

Ku: Njësi të papranueshme = Banesa nuk është gjetur, familjet mungojnë përkohësisht, familjet që nuk janë në gjendje të përgjigjen (arsye shëndetësore), banesat bosh dhe arsye të tjera.

Norma e mos përgjigjes së familjeve (NRh): $NRh = (1 - (Ra * Rh)) * 100$

Ra është norma e kontaktit të adresës.

Rh është përqindja e intervistave të plota familjare të pranuar për bazën e të dhënave.

Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës ka filluar si vit i parë në vitin 2017 por për përlllogaritjen e raportit të Cilësisë dhe për këtë punim janë përdorur edhe të dhënat e vitit 2016 të emërtuar si pilot i madh. Të dhënat e vitit 2016 do të kontribuojnë në këto analiza duke përfshirë të treja vitet në panelin përsëritës 2016, 2017 dhe 2018. Ky kampion përsëritës në tre vite përfshin 18 225 familje dhe norma e mospërgjigjes e llogaritur është 12,66 % .

– Normat individuale të mos-përgjigjes ($NRp = (1 - (Rp)) * 100$) është 0,03% në panelin përsëritës

Rp është përqindja e intervistave të plota personale brenda familjeve të pranuar për bazën e të dhënave.

Tabela 2: Norma e mospërgjigjes në panel përsëritës

Norma e adresave të kontaktuara	Intervistat e familjeve të plotësuara	Intervistat individuale të plotësuar	Norma e mospërgjigjes së familjeve	Norma e mospërgjigjes së individit
(Ra)*	(Rh)*	(Rp)*	(NRh)*	(NRp)*
A*	A*	A*	A*	A*
98,52	88,65	99,97	12,66	0,03

A* - Rezultati për të gjithë kampionin e panelit për tre vite.

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2018, Raporti i Cilësisë 2018

Duke marrë në analizë vetëm vitin 2018 ku përfshihet vetëm kampioni me 7800 familje, në tabelën 3 shohim të dhënat në lidhje me normën e mospërgjigjes vjetore në familje e cila është 9,6 % pra 3.06 pikë më e ulët se në panelin përsëritës, ndërsa norma individuale e mos-përgjigjes është 0 pasi janë realizuar të gjitha intervistat individuale në këtë vit.

Tabela 3: Norma e mospërgjigjes vjetore

Norma e adresave të kontaktuara	Intervistat e familjeve të plotësuara	Intervistat individuale të plotësuar	Norma e mospërgjigjes së familjeve	Norma e mospërgjigjes së individit
(Ra)*	(Rh)*	(Rp)*	(NRh)*	(NRp)*
A*	A*	A*	A*	A*
98,80	91,50	100	9,6	0

A* - Rezultati për kampionin e vitit 2018

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2018, llogaritje të autorit

Për vitin 2018 në Shqipëri, janë përfshirë në kampion 7800 familje për intervistim, nga të cilat një pjesë e intervistave nuk janë realizuar për arsye të mëposhtme të cilat ndikojnë në normën e mospërgjigjes:


- Refuzime;
- Familje të larguara përkohesisht;
- Familje të paafta për tu përgjigjur (probleme shëndetësore);
- Adresa pa kontakt ku përfshihen, banesat që janë të paarrtshme për shkak të kushteve klimatike, banesa boshe, banesa që nuk gjenden si dhe banesat që janë jo për qëllime banimi.
- Familjet lëvizur në banesë kolektive, të gjithë antarët kanë vdekur, familja lëvizur diku tjetër në Shqipëri, familja ka lëvizur jashtë vendit etj.

Në figurën 1 shohim një analizë mbi rezultatet e plotëshmërisë ose jo të pyetësorëve për AANJ për tre rajonet statistikore të ndara sipas ndarjes territoriale:

- Rajoni i Veriut (AL01)
- Rajoni Qendër (AL02)
- Rajoni i Jugut (AL03)

Vëmë re që rajoni qendër ka një nivel më të lartë të pyetësorëve të paplotësuar, kjo lidhet dhe me faktin që ky rajon ka një përfaqësim më të madh në kampion pasi përfshin Tiranën, qytetin me numrin më të madh të popullsisë.

Figura 1: Rezultatet e Pyetësorit sipas rajoneve (%)



Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2018, llogaritje të autorit.

2.1.2 Mospërgjigje në nivel variabli

Mospërgjigja në nivel variabli që i referohet situatës kur një njësi model është numëruar me sukses, por jo të gjitha informacionet e kërkuara janë marrë (Gianni Betti, Vijay Verma, Giulio Ghellini 2006). Gabimet e matjes mund të ndodhin nga anketuesi ose i anketuari ose nga të dy palët. Burimet kryesore të këtij lloji të gabimeve janë pyetësori dhe procesi i mbledhjes së të dhënave.

Mospërgjigja në nivel variabli mund të shihet si një kategori e ndërmjetme midis gabimeve në matje dhe gabimeve në vlerësim. Në të njëjtën kohë, ai mund të shihet thjesht si një shtesë në njësinë ekzistuese të mos përgjigjes në analizë që përfshin variablin e veçantë të prekur, duke sjellë kështu një gabim në vlerësim. Mospërgjigja për variabla është veçanërisht e rëndësishme në AANJ dhe anketa të ngjashme që mbledhin informacion kompleks dhe të hollësishëm mbi përbërësit e familjes dhe të ardhurat personale. Disa përbërës të tillë si të ardhurat nga vetë-punësimi dhe punësimi mund të shfaqin norma të mospërgjigjes së variablit. Informacioni për një variabël mund të jetë i paplotë thjesht sepse nuk është e mundur të kërkohet saktësisht ose në detaje të plota në një pjesë të intervistës; këto gabime janë të ngjashme me gabimet konceptuale. Ndikimi në rezultate mund të ndryshojë në varësi të karakteristikave dhe rrethanave të të anketuarit. Shpesh informacioni mungon sepse i anketuari nuk është në gjendje ta sigurojë atë ose i anketuari mund të mos jetë i gatshëm të sigurojë informacion që konsiderohet shumë i ndjeshëm ose personal. Norma e mospërgjigjes së variablit sigurohet për variablat kryesorë të të ardhurave, si në familje ashtu edhe në nivelin personal.

Tabela 4 më poshtë jep një përmbledhje të mospërgjigjes së variablit për disa nga variablat e përfitimeve. Kolona e parë (përqindja e individëve që kanë marrë një shumë) i referohet të dhënave me informacione të plota për një variabël të caktuar ku përfshin përqindjen e individëve 16 vjeç e lart të cilët kanë marrë një vlerë të ardhure. Kolona e dytë tregon përqindjen e individëve me vlera që mungojnë për variablat e përfitimeve personale. AANJ mbledh të ardhura në nivel neto, më konkretisht komponentët e të ardhurave janë:

- Të ardhurat nga puna,
- Të ardhura nga prona,
- Transferrat sociale dhe pensionet,
- Transferta monetare nga familjet e tjera,
- Të ardhura nga përdorimi i makinës së kompanisë për qëllimë personale,
- Të ardhura nga dividendët dhe interesat bankare,
- Të ardhura të përfituara nga individët nën moshën 16 vjeç.

Meqënëse metodologjia e kësaj ankete kërkon për matje varfërie të ardhurat bruto, llogaritja e të ardhurave neto të mbledhura nga anketa në nivel bruto, realizohet nëpërmjet konvertimit me anë të modelit SM2 (Siena MicroSimulation Model) duke iu referuar legjislacionit tatimor kombëtar. Për këtë arsye variabli “fitimet ose humbjet nga vetë-punësimi” (PY050G) mbledhen në nivel neto dhe duke përdorur modelin e konvertimit nga neto në bruto e gjithë përqinja e mbledhur rezulton si e imputuar në nivelin 18,3%. Variablat e tjerë të paraqitura në tabelë nuk e kanë të nevojshëm konvertimin sipas modelit SM2 pasi janë transferta sociale ose pensione dhe e dhëna neto e mbledhur gjatë periudhës së anketimit është e njëjtë me të dhënë bruto. Imputimet në këtë rast janë realizuar vetëm kur mungon e dhëna në nivel individ për përfitimet e lartë përmendura.

Tabela 4: Variablat bruto të të ardhurave në nivel individual

	% e individëve 16+ që kanë marrë një shumë	% e individëve me vlera që mungojnë (para imputimit)
Fitimet ose humbjet nga vetë-punësimi (PY050 G)	18,3	18,3
Përfitimet e papunësisë (PY090G)	0	0
Përfitimet e pleqërisë (PY100G)	24	0,3
Përfitimet e mbijetesës ose familjare (PY110G)	0,2	0
Përfitimet e sëmundjes (PY120G)	0,1	0
Përfitimet e aftësisë së kufizuar (PY130G)	3,5	0

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2018, Raporti o Cilësisë 2018

3. Përfundimi

Qëllimi i këtij punimi është të bëj lexuesin të vetëdijshëm për ndikimet e mos-përgjigjes, të përshkruaj disa mënyra si imputimi dhe editimi për të zvogëluar efektet e tij për rastin e Shqipërisë.

Të kesh një cilësi të lartë të rezultateve dhe të minimizosh gabimet e mospërgjigjes do të thotë të ndjekësh procedurat e duhura të të gjitha aktiviteteve të studimit, nga hartimi dhe përgatitja e studimit, mbledhja e të dhënave, përpunimi dhe analizimi i të dhënave.

Gabimet e mospërgjigjes janë gabime që duhet t'i kushtohet një vëmendje e madhe në anketat e familjeve, sepse këto lloje gabimesh mund të shkaktojnë paragjyime të mëdha në rezultatet përfundimtare nëse nuk kontrollohen.

Imputimi duhet të përdoret me kujdes dhe variablat që imputohen duhet të identifikohen dhe dokumentohen. Imputimet e bëra në të dhëna duhet të ruajnë të dhënat origjinale dhe përgjigjet origjinale. Editimi i të dhënave duhet të identifikojë dhe të korrigjojë gabimet në të dhëna të paqëndrueshme.

Editimi, kodimi, futja e të dhënave dhe gabimet e programimit lindin gjatë fazës së përpunimit të të dhënave dhe për të minimizuar këto gabime duhet të përdoren kontrolle logjike gjatë kontrolleve të të dhënave.

REFERENCA

- [1] Rebecca R. Andridge, [Roderick J. A. Little](#) (2010), *A Review of Hot Deck Imputation for Survey Non-response*, International Statistical Review
- [2] Gianni Betti, Vijay Verma, Giulio Ghellini (2006), *Cross-sectional and longitudinal weighting in a rotational household panel: applications to EU-SILC*,
- [3] Gianni Betti, Vijay Verma, *Data accuracy in EU-SILC EUROSTAT*, Statistical books, Luxembourg: Publications Office of the European Union
- [4] European Commission (2019), *Methodological Guidelines and description of EU-SILC target variables*, EU-SILC doc 65/01. Luxembourg: Eurostat.
- [5] Maria Iacovou, Olena Kaminska, Horacio Levy (2012), *Using EU-SILC data for cross-national analysis: strengths, problems and recommendations*, Institute for Social and Economic Research, Essex University
- [6] S. Laaksonen, S. Rässler & C. Skinner (2004). DACSEIS research project Workpackage 11, *Imputation and Non-Response*, Eurostat
- [7] S. Rässler (2004) DACSEIS research paper series No. 5 *The Impact of Multiple Imputation for DACSEIS*. (2004)

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Instituti i Statistikave

Infostat 03 /

Instituti i Statistikave ; drejt. bot. Elsa Dhuli.

- Tiranë : INSTAT, 2022

... f. ; ... cm.

ISBN 9

1.Statistika 2.Shqipëri

311.312(

A complex network of white lines and dots on a dark blue background, resembling a data visualization or a molecular structure.

INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

INFOSTAT

📊 📍 🌐

REVISTË INFORMATIVE
NR. 03